



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional “Menaxhim
Biznesi Bujqësor”**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Elena Kokthi (PhD)

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "E. Kokthi", written over a horizontal line.


2. Klodjan Rama (PhD)

A handwritten signature in blue ink, appearing to be "K. Rama", written over a horizontal line.

Prill 2022

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Diplomë Profesionale në “Menaxhim Biznesi Bujqësor”

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Fan.S.Noli Korçë
2	Njësia bazë që e ofron:	Fakulteti i Bujqësisë Departamenti i Agrobiznesit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Diplomë Profesionale në “Menaxhim Biznesi Bujqësor”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 375, datë 5 Korrik 2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Diplomë Profesionale
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuhë Shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	NA
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	NA
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	5
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10/2
18	Numri i studentëve:	33
19	Komente / të tjera:	NA



PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Universiteti Fan.S.Noli Korçë më tej UK, është një institucion publik i arsimit të lartë që zhvillon veprimtari në fushën e arsimit dhe shkencës në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit Nr. 80/ 2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. “UK” është liçencuar me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 230, datë 29.05.1992 dhe është riorganizuar me VKM Nr 213, datë 24.05.1994”.

IAL “UK” është organizuar në 4 Fakultete: **1. Fakulteti i Ekonomisë, 2. Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, 3. Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane dhe 4. Fakulteti i Bujqësisë (FB).** Programi i studimit Diplomë profesionale në "Menaxhim Biznesi Bujqësor" ofrohet nga Fakulteti i Bujqësisë.

Fakulteti i Bujqësisë është i përbërë nga tre departamente:

1. Departmenti i Agrobiznesit
2. Departmenti i Agronomisë
3. Departmenti i Agroushqimit

Departmenti i Agrobiznesit ofron programin e studimit

- i. në ciklin e parë: Bsc në “Menaxhim Agrobiznesi”
- ii. në ciklin e parë DP në “Menaxhimi i Biznesit Bujqësor”
- iii. në ciklin e dytë: MP në “Zhvillim Rural i Integruar”;

Ky raport i vlerësimit të jashtëm analizon programin e studimit diplomë profesionale në "Menaxhim Biznesi Bujqësor" Programi i studimit është liçencuar me UMASR Nr. 405 datë 25.07.2019.

Pranimi i studentëve që ndjekin këtë program studimi të ofruar nga departamenti përkatës pranë UK është realizuar sipas kriterëve që vendos ligji Nr. 80/2015, datë 22/07/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, por dhe të atyre që parashikojnë Statuti i UK dhe Rregullorja e programit të studimit.

Stafi i angazhuar në këtë program studimi (PS) është i përkushtuar dhe posedon eksperiencën e nevojshme për të ofruar një shërbim cilësor. Programi i studimit synon të ofrojë teknikë të lartë në fushën e menaxhimit bujqësor, sektor me shumë interes për vet specifikat e zhvillimit të bujqësisë në zonën e Korçës. Në këtë kontekst ky program studimi ka një rëndësi strategjike në zhvillimin e bizneseve bujqësore në rajonin në fjalë edhe me gjerë. Megjithatë Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) konstaton se programi i studimit ka nevojë për përmirësime të mëtejshme sidomos sa i përket moduleve që lidhen direkt me emërtimin e PS. Më konkretisht GVJ rekomandon: rishikimin e moduleve të përfshira në programin e studimit, përshtatjen e njohurive në përputhje me objektivat e nxënies së profilit të studentit të targetuar nga diploma profesionale.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Procesi i vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit "Diplomë profesionale në "Menaxhim i Biznesit Bujqësor" ofruar nga Departamenti i Agrobiznesit (Fakulteti i Bujqësisë) pranë IAL UK filloi me trajnimin, prezantimin si dhe ndarjen e punës ndërmjet ekspertëve të grupit të vlerësimit të jashtëm. Më pas ky grup, bazuar në dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), filloi shqyrtimin e Raportit të Vlerësimit të Brendshëm si dhe dokumentet përkatëse në mbështetje të tij. Gjatë kësaj faze u identifikuan dhe u listuan një sërë pyetjesh që kishin lidhje me standardet dhe kriteret përkatëse, të cilat do të merrnin përgjigje gjatë takimeve që do të realizoheshin në IAL.

Vizita 2 ditore në IAL UK u realizua gjatë datave 18-19/10/2021, ku Grupi i Vlerësimit të Jashtëm, realizoi takimet e përcaktuara në axhendën e vizitës në IAL. Gjatë kësaj vizite 2-ditore, GVJ u takua me: Dekanin e FB dhe Përgjegjësin e Departamentit, me Zyrën e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, me përfaqësues të Zyrës së marrëdhënieve me jashtë, projekteve / pranimeve dhe këshillimit për karrierën, grupin e vlerësimit të brendshëm (GVB), me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi me përfaqësues të Zyrës së Burimeve Njerëzore si dhe stafin e sekretarisë mësimore.

Gjatë këtij takimi u shqyrtuan çështje të ndryshme që lidhen me vlerësimin e programit të studimit në fjalë, duke sqaruar edhe elementë të veçantë, për të cilat ishin ngritur pyetje përkatëse.


Pas vizitës në IAL, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm filloi punën për të hartuar raportin e vlerësimit të jashtëm bazuar në dokumentacionin në dispozicion dhe informacionin e mbledhur gjatë takimeve dhe vizitave të realizuara në këtë Institucion. Në përfundim të këtij procesi ky grup dorëzon draft-raportin tek eksperti përkatës i ASCAL.

Gjatë gjithë procedurës GVJ është asistuar nga koordinatori teknik i ASCAL, MSc Juna Mengri.

Më datë 31.01.2022 përmes sistemit AMS, Universiteti Fan S. Noli, Korçë është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm për këtë program studimi dhe me shkresë zyrtare Nr. Prot. 4/5, datë 31.01.2022.

Më datë 03.02.2022, Universiteti Fan S. Noli, Korçë përcjell në sistemin AMS shkresën me Nr. Prot. 169/1, datë 03.02.2022, me të cilën shpreh dakordësinë me përmbajtjen e draftit.

Sa më sipër, Draft- Raporti kthehet në Raport përfundimtar.



Vlerësimi i Programit të Studimit me karakter profesional “Menaxhim i Biznesit Bujqësor”

I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi me karakter profesional në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij dhe në përputhje me nevojat e kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Referuar dokumentacionit, programet e studimit të ofruar në IAL “UK” janë të hartuara sipas Plani Strategjik 2016-2020 (<i>Shtojca 1.3 Plani strategjik UK ,2016-2020.</i>), i cili është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. I orientuar drejt zhvillimit të kurikulave dhe mësim-dhënies, kërkimit shkencor, partneritetit dhe ndërkombëtarizimit. Në strategjinë e UK paraqiten objektivat zhvillimore në fushat e përmendura më sipër. Këto objektiva paraqiten të detajuar edhe për departamentin e Agrobiznesit në Fakultetin e Bujqësisë.</p> <p>Me rëndësi specifike për programin e studimit profesional dy-vjeçar në “Menaxhim Biznesi Bujqësor” është objektivi i forcimit të partneritetit me institucione të ndryshme publike dhe private në sektorë të ndryshëm të cilët do i ofronin studentëve mundësi për praktika mësimore dhe orientimi drejt mundësive të punësimit pas përfundimit të studimeve. Nga takimi me stafin e angazhuar në këtë program studimi u theksua nevoja e agrobizneseve në zonën e Korçës për burime njerëzore të cilësuar si teknikë të lartë në fushën e bujqësisë dhe sektorëve që lidhen ngushtë me të.</p> <p>- SHTOJCA 1.3 PLANI STRATEGJIK UK 2016-2020 -SHTOJCA 1.3.1 DRAFT PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UK</p>
Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit duhet të përcaktojnë qartë drejtimit prioritare akademike të tij dhe të demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	<p>Rregullorja UK më konkretisht Neni 57 i rregullores (faqja 48) që lidhet me programet e studimit të karakterit profesional paraqet përcaktimet rregulluese që janë të lidhura me programet e studimit profesional dy-vjeçar, organizimin në kredite, formën e zhvillimit etj. Megjithatë në këtë rregullore duhet të bëhet kujdes me pikën 2 të Nenit 57 ku paraqitet: <i>Kreditet e grumbulluara gjatë studimeve me karakter profesional mund të transferohen në studimet e ciklit të parë, që i referohen nivelit të 6 të Kornizës Shqiptare të Kualifikime, sipas kriterëve të përcaktuara në rregulloret e programeve të studimit të hartuara nga njësitë bazë që ofrojnë programe të tilla</i>”. Specifikime të tilla duhet të mbështeten në ligj dhe rekomandohet korrektimi i tyre sepse shkakton konfuzion në aktorë të ndryshëm që lidhen direkt ose indirekt me këtë program studimi dhe për rrjedhojë edhe në strategjitë e rekrutimit të studentëve të targetuar nga programi i studimit në fjalë.</p> <p>- SHTOJCA 1.1 STATUTI I UK -SHTOJCA 1.1.1 DRAFTSTATUTI I NDRYSHUAR I</p>

	<p>UNIVERSITETIT FAN S. NOLI - SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK. - SHTOJCA 1.3.1 DRAFT PLANI STRATEGJIK I ZHVILLIMIT TË UK.</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimeve ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit, si dhe fushën akademike të njësisë kryesore/kolegjit profesional dhe atë të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit ofrohet në përputhje me fushat e drejtimet akademike të Fakultetit të Bujqësisë, si dhe fushën akademike të departamentit të Agrobiznesit. Ky i fundit përpos programit të studimit profesional, në Menaxhim Biznesi Bujqësor, ofron në ciklin e parë diplomë në “Menaxhim Agrobiznesi” si dhe në ciklin e dytë “Master Profesional në Zhvillim Rural të Integruar”.</p> <p>GVJ gjykon që tre programet e studimit të lartpërmendura janë një mundësi e mirë për të ofruar një qasje holistike të kompetencave që ofrohen nga njësisia bazë. Kjo do të thotë që stafi i angazhuar në të tre programet e studimit ka një vizion më të gjerë se si duhet të implementohen modulet në përputhje me nevojat e ndryshme të studentëve në të tre ciklet (profesional, bachelor dhe master). Kompetencat e ofruara në nivelin ciklin e parë dhe të dytë mund ti shërbejnë stafit të përfshirë në programin e studimit për të ofruar një qasje me praktike në nivelin profesional. Nga takimi i GVJ-së me drejtuesin e njësisë bazë si dhe stafin e angazhuar në programin e studimit u vu re disponibiliteti për të përshtatur vazhdimisht përmbajtja e programit të studimit me elementë praktikë të zhvillimit të biznesit bujqësor.</p> <p>Një element tjetër për tu përmendur dhe që mund të ndikojë në cilësinë e programit të studimit dhe qëndrueshmërinë e tij në të ardhmen është përfshirja e stafit të angazhuar në projekte ndërkombëtare si SMART-AL, katër anëtarë të përfshirë në programin e studimit në shqyrtim. Projekte të cilat lidhen kryesisht me ngritjen e kapaciteteve në Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural mund të ndihmojnë në përmirësimin e përmbajtjes së njohurive të lidhura me biznesin bujqësor duke i dhënë atij karakteristika unike në vend dhe duke e bërë më kompetitiv edhe në rang kombëtar.</p> <p>- 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE</p>
<p>Kriteri 4. Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit me karakter profesional mbështetet në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.</p>	<p>Propozimi, hartimi dhe realizimi i programit të studimit është i mbështetur në një studim tregu (3.12 STUDIM TREGU PERIODIK NE KUADER HAPJEJE PROGRAMI STUDIMI.). Në raportin e kërkimit të tregut evidentohet identifikimi i nevojave të bazuara te sektori i biznesit në rajonin e Korçës. Në këtë raport vihet re identifikimi i nevojave të punësimit të lidhura me ato që quhen hard skills- në fushën e ekonomisë, fushën e teknologjisë, burimeve njerëzore, sistemeve teknologjike si dhe vlerësimi i njohurive-soft skills në fushën e komunikimit, cilësive personale dhe eksperiencës.</p> <p>GVJ gjykon që evidentimi i nevojave në një spektër të gjerë njohurish dhe kompetencash i jep mundësinë njësisë bazë të evidentojë prioritetet dhe të hartojë programin e studimit në përputhje me to. Po kështu përfshirja e stafit në studim jep një vlerë të shtuar në evidentimin e nevojave duke qenë se janë njohës të sektorit dhe kërkesave të tregut në afatin e shkurtër dhe atë të mesëm. Nga takimi me stafin rezulton gjithashtu që organet drejtuese kanë zhvilluar</p>

	<p>takime konsultuese për evidentimin e nevojave edhe me përfaqësues të Qëndrave të Transferimit të Teknologjiwe Bujqësore në rajonin e Korçës. Nga këto takime identifikohen nevojat që lidhen specifkisht me sektorin bujqësor.</p> <p>Megjithatë GVJ rekomandon që këto konsultime edhe pse janë zhvilluar në mënyrë periodike të dokumentohen në mënyrë që të ndihmojnë në vijimësi procesin e analizës dhe evolimit të programit të studimit.</p> <p>GVJ rekomandon gjithashtu që në kërkimin e tregut të evidentohen edhe nevojat në nivel kombëtar për të dhënë një pamje më të qartë për mundësitë e punësimit të shtrira jashtë rajonit të Korçës.</p> <p>Po kështu në analizën e kërkimit të tregut nevojitet një përshkrim i llojit të bizneseve të cilat mund të jenë potencial për punësimin e studentëve që përfundojnë këtë program studimi. Për shembull cili ishte përfaqësimi i bizneseve bujqësore dhe blegtorale të përfshira në studim dhe nga ndryshojnë nevojat e tyre me sektorët e tjerë.</p> <p><i>-3.12 STUDIM TREGU PERIODIK NE KUADER HAPJEJE PROGRAMI STUDIMI.</i></p>			
<p>Kriteri 5. Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, zhvillohen studime periodike mbi tregun e punës, ndryshimet përkatëse dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Gjatë realizimit të programit të studimit, nga pranimi në diplomim dhe pas daljes së studentëve në punë, IAL zhvillon studime periodike mbi tregun e punës. Nga takimi me stafin e angazhuar rezulton që ka një komunikim të vazhdueshëm me aktorët në tregun e punës, si sektori i biznesit privat edhe sektori shtetëror që lidhet kryesisht me aktivitetet bujqësore dhe blegtorale. Megjithatë GVJ gjykon që ky proces duhet të institucionalizohet dhe dokumentohet.</p>			
<p>Kriteri 6. Studimet paraprake dhe periodike të tregut të punës për programet me karakter profesional duhet të përfshijnë të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Ekzistenca e një numri të konsiderueshëm bizneseve bujqësore për vet specifikën e zhvillimit të rajonit të Korçës lehtëson procesin e bashkëpunimit midis aktorëve. Megjithatë GVJ rekomandon ashtu si u përmend edhe më sipër, institucionalizimin e procesit të: 1) evidentimit të nevojave, 2) mundësitë e punësimit dhe 3) zhvillimet e pritshme. Gjykojmë që institucionalizimi në nivel fakulteti apo IAL-je të një metodologjie të njehsuar në evidentimin e nevojave do të rrisë ndjeshëm cilësinë e gjetjeve dhe për rrjedhojë edhe të programit të studimit.</p> <p><i>- 3.12 STUDIM TREGU PERIODIK NE KUADER HAPJEJE PROGRAMI STUDIMI</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit dhe me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, dhe në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Mbarëvajtja, mbikëqyrja dhe marrëdhëniet e institucionale të personelit dhe stafit akademik të programit të studimit profesional dy-vjeçar “Menaxhim Biznesi Bujqësor” është e përcaktuar në rregulloret e brendshme të institucionit, si vijon: <i>Rregullorja e UK, Rregullorja e njësisë kryesore, Rregullorja e njësisë bazë, Rregullorja e programit të studimit në shqyrtim, Analiza vjetore e Departamentit të Agrobiznesit etj.</i></p> <p>Analiza vjetore e aktivitetit të departamentit të Agrobiznesit reflekton përgjegjësinë e stafit për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e mësimdhënies dhe kontaktin me studentin. Pavarësisht plotësimit të kuotave në rekrutimin e studentëve për vitin 2019-2020, në raportin e vlerësimit të punës së njësisë bazë vihet re shqetësimi për trendin e reduktimit të studentëve në vite. Në këtë kuadër stafi i angazhuar në këtë program studimi propozon një sërë masash që kanë në qendër studentin si dhe cilësinë e programit të studimit. Më konkretisht masat janë propozuar në kuadër të objektivave të mëposhtëm.</p> <p>Objektivi 1: Përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit, rezultateve të të nxënit dhe profilet e të diplomuarve edhe në raport me nevojat e individëve dhe shoqërisë.</p> <p>Objektivi 2: Ristrukturimi i programeve ekzistuese në përmbushje të kërkesave të tregut</p> <p>Objektivi 3: Përmirësimi i kurrikulës me bazë të nxënit</p> <p>Objektivi 4: Përmirësimi i shërbimeve në mbështetje të studentit për të rritur cilësinë e studimeve dhe jetës studentore</p> <p>Objektivi 5: Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies duke përdorur metodologji të reja të teknologjisë së informacionit dhe nxitja e kualifikimit të stafit akademik në përmirësimin e aftësisë pedagogjike.</p> <p>GVJ gjykon që analiza të tilla janë një praktikë e mirë e cila komunikon te palët e interesuara ecurinë e programeve të studimit dhe masat përkatëse në arritjen e objektivave të vendosur.</p> <p><i>-SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK</i> <i>-SHTOJCA 2.2 RREGULLORE E NJESISE KRYESORE.</i> <i>- SHTOJCA 2.3 RREGULLORE E NJESISE BAZE</i> <i>-SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> <i>-SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE</i></p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave të procesit mësimor, formimin teorik e praktik të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie afatgjata e të qëndrueshme bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, me punëdhënësit vendës, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet një listë me aktorë në sektorin publik dhe privat në rajonin e Korçës. Gjithashtu njësia bazë ka hartuar dhe raport analitik ku evidentohen marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe përfitimet nga këto marrëveshje. IAL ka paraqitur edhe një listë e organizatave të biznesit ku studentët mund të zhvillojnë praktikën mësimore. Megjithëse njësia bazë ka vendosur një sërë indikatorësh lidhur me përfitimin nga bashkëpunimet,</p>

huaj.	GVJ rekomandon shtrirjen e bashkëpunimit në një numër më të madh aktorësh rajonalë dhe kombëtare. Nga takimi me stafin e angazhuar në programin e studimit vihet re një bashkëpunim i vazhdueshëm me aktorët e biznesit dhe qeverisjes lokale në rajonin e Korçës por më shumë përpjekje duhen për ta formalizuar këtë proces.			
Kriteri 3. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	- SHTOJCA 3.5 TABELA E INSTITUCIONEVE BASHKEPUNUESE PER PRAKTIKAT			
Kriteri 4. Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	- SHTOJCA 3.6 RAPORTI I PERFITIMEVE NGA MARREVESHJET NE FUNKSION TE PROGRAMIT TE STUDIMIT			
Kriteri 5. Institucioni ndërmerri iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit si dhe nga informacionet e marra nga takimi me drejtuesin e departamentit dhe stafin e angazhuar në këtë program studimi vihet re një përpjekje e stafit për tu angazhuar më shumë në procesin e promovimit të programit të studimit si dhe në gjurmimin e studentëve të punësuar nëpërmjet një database të krijuar në kuadër të zyrës së Alumni. Gjithashtu në raportin e vlerësimit të njësisë bazë paraqitet që programi i studimit profesional dy vjeçar Menaxhim Biznesi Bujqësor, rezulton me një përqindje më të lartë të punësimit studentëve të diplomuar krahasuar me dy programet e tjera të studimit që ofron departamenti i Agrobiznesit. Kështu, 12% e studentëve të diplomuar në programin e studimit profesional janë punësuar kundrejt 3% të punësuar të diplomuar në “Agrobiznes” dhe 8% Zhvillim i Integruar Rural (Analiza vjetore e njësisë bazë, Tabela 15, të dhena për gjurmimin e studentëve që kanë përfunduar studimet për secilin program studimi në departamentin e Agrobiznesit).</p> <p>- SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi dhe Kuadrin Evropian e Shqiptar të Kualifikimeve për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimeve janë të organizuara në lëndë/module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur nga IAL pranë ASCAL, rezulton që programi i studimit Menaxhim Biznesi Bujqësor është organizuar në lëndë/module të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i studimit diplomë profesionale dy-vjeçare është organizuar në bazë të legjislacionit të arsimit të lartë në fuqi, Ligji nr. 80/2015 datë 22.07.2015, neni 72.</p> <p>- SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</p> <p>- SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</p>
Kriteri 2. Programet e studimeve me	Referuar dokumentacionit të dorëzuar dhe pas vizitës së kryer në UK si



<p>karakter profesional synojnë përfitim e njohurive gjithë përfshirëse të specializuara teorike dhe praktike brenda një fushe punësimi në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>dhe nga takimet e zhvilluara me stafin e angazhuar me programin e studimit rezultojnë që ky kriter plotësohet. Programi synon ofrimin e njohurive teorike dhe praktike sipas profilit përkatës.</p> <p>- <i>SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> - <i>2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit me karakter profesional synojnë pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithëpërfshirëse që nevojiten për të zgjidhur në mënyrë krijuese probleme të karakterit profesional praktik.</p>	<p>Programi i studimit Menaxhim Biznesi Bujqësor synon pajisjen e studentëve me një sërë aftësish njohëse dhe praktike gjithë përfshirëse. Në program janë përfshirë lëndë si bazat e ekonomisë, lëndë që lidhen me marketingun e produkteve bujqësore, menaxhimin e agrobiznesit, menaxhimin e burimeve njerëzore etj. Këto module synojnë të ofrojnë njohuri gjithëpërfshirëse megjithatë nevojitet që modulet të përshtaten për nevojat e studentit target për këtë program studimi.</p> <p>- <i>SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> - <i>SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit me karakter profesional synojnë zhvillimin e kompetencave për menaxhimin dhe mbikëqyrje në kuadrin e veprimtarive profesionale dhe orientimin e duhur në situata të ndryshme e të ndryshueshme.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës si dhe takimet me përfaqësuesit në IAL (të lidhur direkt dhe indirekt me programin e studimit), GVJ gjykon që nevojitet një përshtatje e objektivave për studentin e targetuar për këtë program studimi. Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL, është e rekomandueshme që objektivat për formimin profesional të mos formulohen në mënyrë përgjithësuese, por të përshtaten dhe nivelit të studentëve dhe lëndëve të tjera që ofrohen nga programi Menaxhim Biznesi Bujqësor.</p> <p>Nga takimet me stafin e angazhuar në programin e studimit në shqyrtim, pedagogët u shprehën që programet e lëndëve përshtaten sipas nevojave të studentëve dhe që paraqitja aktuale e tyre e cila mbështetet në një pjesë të konsiderueshme në nivel teorik kombinohet me raste studimore praktike.</p> <p>-<i>SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> -<i>SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni/njësia kryesore/kolegji profesional dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në IAL rezultojnë që njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit “Menaxhim Biznesi Bujqësor” përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë të organizimit, strukturës akademike dhe numrit e shkallës së kualifikimit të stafit akademik. Nga shqyrtimi i stafit përgjegjës titullar në modulet e përfshira në programin e studimit, plotësohet kushti sipas të cilit, titullari i modulit që është garanti për cilësinë e tij i përket kategorisë profesor.</p> <p>Sidoqoftë, vërehet një mospërputhje e lehtë për sa i përket personelit akademik të propozuar në Strukturën e Planit Mësimor për Vitin Akademik 2020-2022 (Pika 8 fq, 9 e Shtojcës 2.5) dhe syllabuseve për modulet respektive, ku në syllabus përmendet një emër ndërsa në strukturë nuk figurojnë (shih Rregulloren e Programit të Studimit, Shtojca 2.5). Për shembull, pedagogët e moduleve Matematikë e Aplikuar, Mbledhje dhe Përpunim të Dhënash, Menaxhim i Burimeve Njerëzore dhe Bazat e Marketingut, etj nuk figurojnë në strukturën e programit, ndërkohë që figurojnë titullarë në lëndë bazë dhe karakterizuese.</p>

	<p>-SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT -SHTOJCA 1.8 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT -SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</p>			
<p>Kriteri 6. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës (programet e lëndëve si dhe objektivat e përgjithshëm të tyre), GVJ gjykon që nevojitet një përshtatje e objektivave për studentin e targetuar për këtë program studimi. Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL, është e rekomandueshme që objektivat për formimin profesional të mos formulohen në mënyrë përgjithëse, por të përshtaten dhe nivelit të studentëve dhe lëndëve të tjera që ofrohen nga programi “Menaxhim Biznesi Bujqësor”. Nga takimet me stafin e angazhuar në programin e studimit në shqyrtim, pedagogët u shprehen që programet e lëndëve përshtaten sipas nevojave të studentëve dhe që paraqitja aktuale e tyre e cila mbështetet në një pjesë të konsiderueshme në nivel teorik kombinohet me raste studimore praktike. Megjithatë kjo praktikë duhet të dokumentohet dhe të paraqitet si aneks shtesë me syllabusin e lëndës në rastet kur aplikohet. Vihet re gjithashtu që një pjesë e konsiderueshme e moduleve të ofruara në ciklin profesional ofrohen edhe në ciklin e parë të studimeve në programin e studimit “Agrobiznes”.</p> <p>Rekomandohet të rishihen disa prej moduleve të përfshira në këtë program studimi për të rritur cilësinë dhe qëndrueshmërinë e tij në të ardhmen.</p> <p>Në raportin e analizës së programit të studimit të paraqitur nga Departamenti i Agrobiznesit për vitin 2020-2021, vihet re një numër i madh aplikimesh për programin e studimit dy vjeçar “Menaxhim Biznesi Bujqësor”. Numri i studentëve që ka aplikuar në këtë program është 395 studentë kundrejt 55 aplikime për programin e studimit Agrobiznes (Bachelor) dhe 29 aplikime në Zhvillim I Integruar Rural (Master profesional). GVJ gjykon që ky trend duhet të merret në konsideratë nga departamenti për të përforcuar këtë program studimi në drejtim jo vetëm të moduleve të ofruara por edhe në drejtim të targetimit të studentëve potencialë. Rekomandimet për këtë aspekt vijnë në vlerësimin e standartit të dytë.</p> <p>- SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE - SHTOJCA 1.8 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT -SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

2 STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimeve me karakter profesional janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të këtij niveli dhe mundësitë e punësimit	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programet e studimit me karakter profesional, përmbajnë dhe japin informacionet e nevojshme për objektivat formuese, rezultatet e pritshme të të nxënit, organizimin, strukturën, përmbajtjen, fushat e mundshme të punësimit apo të dhëna reale të punësimit të studentëve të diplomuar në këto programe.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL, posaçërisht syllabuset e lëndëve (Shih shtojca 2.8 programet lëndore), programi i studimit D.P. “Menaxhim Biznesi Bujqësor” jep informacion mbi objektivat formuese, rezultat e pritshme të të nxënit etj. Për sa i përket fushave të punësimit ato janë të paraqitura në strategjinë e programit dhe në studimet e tregut. Në analizën e të punësuarve pas diplomimit për këtë program studimi është 12% e studentëve të diplomuar. Përqindja e punësimit për këtë program studimi është më e lartë nëse do ta krahasonim me dy diplomat e tjera që ofron departamenti i Agrobiznesit.</p> <p><i>-SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE</i></p>
<p>Kriteri 2. Programet e studimit janë të organizuara në module/lëndë e aktivitete formuese, të vlerësuara me kredite, të ndara në vite e semestra e që janë në përputhje me përcaktimet vendëse e evropiane në fuqi.</p>	<p>Bazuar në planin mësimor si dhe në syllabuset e moduleve të përfshira në programin e studimit, rezulton që organizimi në module, kredite, semestra është realizuar sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.</p> <p><i>Ligji nr. 80/2015 datë 22.07.2015.</i></p> <p><i>-SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE</i> <i>- SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> <i>- SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ndjekjen e programit, vlerësimin e dijeve, aktivitete specifike etj.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL dhe vizites ne IAL vërehet se programi i studimit “Menaxhim Biznesi Bujqësor” përmban informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin, vlerësimin e dijeve etj. Ne planin mesimor si dhe ne programet e lendeve ofrohet ne menyre te detajuar, objektivat e lendeve, forma e kontrollit, literatura, njohurite e perfituara etj.</p> <p><i>- SHTOJCA ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE</i> <i>- SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> <i>- SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> <i>- SHTOJCA 3.19 MODEL PROGRAMI I SHKURTUAR</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët e aktivitetet formuese të programit të studimit.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL si dhe gjatë takimeve të kryera në institucion gjatë vizitës së GVJ, vërehet se syllabuset e programit të studimit përmbajnë syllabuset e detajuara për të gjitha lëndët. Syllabuset e hartuara janë konform VKM 41.</p> <p><i>- SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> <i>- SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE</i></p>

	STUDIMIT
<p>Kriteri 5. Struktura dhe organizimi i programit të studimit është mjaftueshmërisht fleksibël për të mundësuar formimin e studentëve përgjatë programit dhe në përshtatje me punësimin.</p>	<p>Referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë ASCAL si dhe gjatë takimeve kryer në institucion gjatë vizitës së GVJ, vërehet se <i>struktura dhe organizimi i programit të studimit, ka nevojë të aktualizohen dhe të përshtaten si me nivelin e diplomës së ofruar ashtu edhe me tregun e punës.</i> Vihen re ngjashmëri sa i përket moduleve të ofruara me programin e studimit në ciklin e parë të studimeve “Agrobiznes”</p> <p>Në disa module, dijet ofrohen në leksione dhe seminare të cilat parashikojnë frekuentim të paktën deri në 75% të ngarkesës akademike. Kjo nuk i mundëson studentëve mjaftueshëm fleksibilitet për të qenë në terren, nga ku studentët do të përftonin aftësi të nevojshme për tu përshtatur me tregun e punës. Po kështu, kontrolli i njohurive në një pjesë të moduleve është 70% provim me shkrim dhe 30% vlerësime të marra gjatë semestrit (psh lënda Bazat e Ekonomisë ,Prodhim Shtazor). Megjithatë, nga analiza e lëndëve të programit të studimit një pjesë e konsiderueshme e moduleve aplikojnë kontrollin e dijeve sipas skemës 50/50. Provimi me shkrim përbën 50% të notës finale dhe pjesa praktike me detyra, projekte zë pjesën tjetër. Rekomandohet që kjo praktikë të bëhet e mundur edhe në module të tjera për të theksuar në këtë mënyrë karakterin praktik të secilit modul.</p>
<p>Kriteri 6. Mësimi praktik dhe i elementeve të punës konkrete u është dhënë vendi dhe pesha e duhur në strukturë, vlerësim dhe rivlerësim.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe në diskutimet me stafin dhe studentët kryer gjatë vizitës në institucion, pjesa praktike e mësimdhënies rekomandohet të ketë një peshë më të madhe në planin mësimor të programit të studimit. Kjo është e rëndësishme për vetë natyrën e diplomës, e cila është e orientuar dhe ka si qëllim të formojë profesionistë të karakterit zbatues (praktik) të cilët do ti shërbejnë tregut të punës në sektorin e bujqësisë.</p> <p>Bazuar në planin mësimor dhe syllabuset përkatëse, praktika-laboratori zë një peshë të vogël në shumë module. Module si Menaxhim Agrobiznesi, Drejtimit Ferme, Ekstension Bujqësor, apo Baza të Prodhimit Bimor dhe Prodhim Shtazor kanë nevojë për më shumë ekspozim praktik për studentin, duke i mundësuar vizita dhe pjesëmarrje aktive si në agrobiznese, ferma bujqësore apo institucione publike siç janë Agjencitë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor (AREB), ku studentët mund të shohin nga afër proceset e përditshme në këto entitete. Ashtu si përmendet edhe nga përfaqësuesi i njësisë kryesore (<i>Mendimi i Dekanit të Fakultetit të Bujqësisë shtojca 3.1</i>) studentët që zgjedhin programin e studimit dy vjeçar në “Menaxhim Biznesi Bujqësor” kanë mundësi të mira për tu punësuar në institucione vendore në rajonin e Korçës si Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), Qëndrat e Transferimit të Teknologjiive Bujqësore (QTTB), Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor Korçë (AREB) etj.</p> <p>Në takimin me stafin e programit të studimit u theksua që pjesa praktike zhvillohet në biznese lokale dhe në institucionet e përmendura por IAL duhet të bëjë përpjekje për ti dokumentuar ashtu si është përmendur edhe më sipër.</p> <p>Rekomandohet gjithashtu që në këtë program studimi të ftohen bashkëpunëtorët e biznesit dhe përfaqësues të zyrave të ndryshme për të referuar aspekte praktike të menaxhimit të</p>

	bizneseve bujqësore në rajonin e Korçës edhe me gjerë.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi II.2	
Struktura, plani mësimor dhe shpërndarja lëndore e programeve të studimit me karakter profesional, është në përputhje me objektivat formuese, rezultateve të të nxënit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve dhe kërkesave të tregut të punës për këto programe.	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja e në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore është në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Elementët e programit të studimit “Menaxhim Biznesi Bujqësor” si struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore janë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Programi është i ndarë në 2 vite, katër semestra, në 120 ECTS.</p> <p>Në programin profesional, "Menaxhim Biznesi Bujqësor" në vitin akademik 2021-2022 në të dy semestrat janë zhvilluar 1500 orë në total. Nga këto 646 orë janë zhvilluar brenda auditorit (ose 43% e ngarkesës mësimore) dhe 854 orë jashtë auditorit ose (57%). Po kështu në vitin e dytë akademik 2022-2023, janë parashikuar 1500 orë, nga të cilat 553 orë në auditor dhe 947 orë jashtë auditorit. Pra 40% e orëve totale në dy vitet akademike zhvillohet në auditor dhe 60% jashtë auditorit. Orët mësimore në auditor zhvillohen në formën e leksioneve, seminareve, ushtrimeve dhe laboratoreve. IAL ka ndjekur VKM-nr.185 (date 25.03.2021 ndryshim i VKM 41) për raportin midis aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atij praktik (50/50) por nuk ka detajuar se si shpërndahet ngarkesa jashtë auditorit. GVJ rekomandon që të klasifikohen orët jashtë auditorit në orë praktike dhe orë studimi nga vet studenti sepse kështu mund të evidentohet karakteri praktik dhe profesional i programit të studimit.</p> <p>- <i>SHTOJCA 1.8 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p> <p>- <i>SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 2. Emërtimi, struktura dhe shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit, rezultateve të pritshme të të nxënit dhe punësimin e studentëve.</p>	<p>Nga shqyrtimi i programit të lëndës, GVJ gjykon që për arritjen e objektivave të programit të studimit si në aspektin e të nxënit dhe të punësimin, është e nevojshme një aktualizim dhe një përshtatje me e madhe praktike e strukturës së programit.</p> <p>GVJ rekomandon:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Përfshirjen e lëndëve praktike që lidhen me shkrimin e një projekti si dhe principet e tij. Projekti dhe menaxhimi i tij përbën një “modus operandus” i cili aftëson teknikët në fusha të ndryshme në një mënyrë menaxhimi të strukturuar dhe që rrit efikasitetin. 2. Integrimin e aspekteve teknike që lidhen me menaxhimin mjedisor duhet të bëhen më prezente në

	<p>programin e studimit duke pasur parasysh trendet e zhvillimit të bujqësise dhe aplikimit të principeve të zhvillimit të qëndrueshëm.</p> <p>3. Në lëndët që lidhen me marketingun mund ti kushtohet një vëmendje e veçantë marketingut të territorit dhe të produkteve me vlerë të shtuar të lartë të cilat janë të shprehura në rajonin e Korçës si një nga drejtimet kryesore të zhvillimit të agroturizmit.</p> <p>GVJ mendon qe te stafi i disponon mundësitë për të ofruar lëndët që janë sugjeruar me sipër.</p> <p>- SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</p>
<p>Kriteri 3. Plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, syllabuset e moduleve e të aktiviteteve formuese janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p>	<p>Referuar planit mësimor dhe syllabuseve të lëndëve, plani mësimor, natyra dhe emërtimi i moduleve/lëndëve, janë informuese dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara.</p> <p>Në planin mësimor është detajuar shpërndarja e lëndëve në semestra, numri i krediteve, klasifikimi i lëndëve sipas VKM 41 në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese. Po kështu përveç syllabuseve është paraqitur edhe informacion i shkurtuar për programin e studimit ku paraqiten syllabuse të shkurtuara me objektivat formuese të lëndëve, format e kontrollit te dijeve, literatura etj.</p> <p>- SHTOJCA 3.19 MODEL PROGRAMI I SHKURTUAR - SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</p>
<p>Kriteri 4. Ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimin në praktikë/punë konkrete në profesion.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit që lidhet me modulet e ofruara në këtë program studimi është e vështirë të evidentohet nëse pedagogët mundësojnë një raport të balancuar midis aktiviteteve të formimit teorik dhe atij praktik (50:50) dhe pse në takimet në IAL u pohua që ky aspekt zbatohet në praktikë. Megjithatë ashtu si është përmendur edhe më sipër duhet që një praktikë e tillë të dokumentohet në mënyrë që ti shërbejë përmirësimit të vazhdueshëm të moduleve dhe pasurimit të tyre me raste studimore praktike. Ashtu si është analizuar më sipër, IAL në planin mësimor ka detajuar orët mësimore në auditor të cilat janë në raportin 40% (në leksione, seminare, ushtrime, laboratore) por nuk detajon se si shpërndahen 60% e orëve jashtë auditorit.</p> <p>Në listën e moduleve që përbëjnë këtë program studimi rreth 70% e moduleve e organizojnë kontrollin e njohurive në formën e projekteve dhe detyrave praktike ky është një aspekt që vlerësojmë duhet të shtrihet edhe në modulet e tjera.</p> <p>- SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</p>
<p>Kriteri 5. Klasifikimi sipas aktiviteteve formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues dhe</p>	<p>IAL ka ndjekur VKM-nr.185 (date 25.03.2021 ndryshim i VKM 41) për tipologjinë e lëndëve dhe peshën e tyre në kredite.</p>

<p>orientimin e studentit drejt studimeve të mëtejshme dhe/ ose në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Lëndët bazë përbëjnë 15% të krediteve (Matematikë e Aplikuar, Komunikim Biznesi, Mbledhje dhe Përpunim të Dhënash, Bazat e Ekonomisë).</p> <p>Lëndët karakterizuese përbëjnë 52.5% të krediteve (Bazat e Kontabilitetit, Bazat e Marketingut, Çmimet e produkteve bujqësore, Menaxhim Agrobiznesi, Politika e menaxhimit të biznesit, Menaxhim i Burimeve Njerëzore, Ekonomi Bujqësore, Menaxhim i Biznesit të Vogël, Menaxhim i Mekanikës Bujqësore, Drejtim Ferme, Marketing Agrar, Ekstension Bujqësor.</p> <p>Lëndët ndërdisiplinore përbëjnë 13,3% të krediteve (Prodhim Shtazor, Bazat e Prodhimit Bimor, Bimet e arave).</p> <p>Lëndë plotësuese përbëjnë 15% të krediteve (Laborator Informatike Gjuha Angleze)</p> <p>Detyrimet përmbyllëse përbëjnë 4.2% të krediteve.</p> <p>Megjithëse IAL ka ndjekur VKM nr 185 në hartimin e programit të studimit. Për arritjen e objektivave formues dhe orientimin drejt tregut të punës, është e nevojshme që programi të rishikohet si në aspektin formues përmes aktualizimit pëmbajtësor të moduleve ashtu edhe në raportin teori-praktikë. GVJ ka dhene rekomandime per llojin e moduleve qe mund te perfishihen ne programin e studimit ne kriteret e meposhtme.</p> <p>- SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT -SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

<p>Standardi II.3</p>	
<p>Përbajtja e lëndëve, moduleve dhe formave të tjera formuese të programeve të studimit me karakter profesional është në përputhje me objektivat formuese, rezultatet e të nxënit dhe kërkesat e tregut të punës për këto programe</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përmban të dhëna të plota mbi përbajtjen e moduleve/lëndëve të formimit teorik e praktik dhe aktiviteteve të tjera të formimit sipas strukturës e planit të studimit.</p>	<p>Në planin mësimor është detajuar shpërndarja e lëndëve në semestra, numri i krediteve, klasifikimi i lëndëve sipas VKM 41. Po kështu përveç syllabuseve është paraqitur edhe informacion i shkurtuar për programin e studimit ku paraqiten syllabuse të shkurtuara me objektivat formuese të lëndëve, format e kontrollit te dijeve, literatura etj. Në këtë program studimi ofrohen lëndë që lidhen me ekonominë si Bazat e Ekonomisë dhe Ekonomia Bujqësore. GVJ mendon që në një program studimi dy vjeçar këto dy lëndë mund të shkrihen në një të vetme. Shkrimi mund të krijojë hapësira për përfshirjen e moduleve të tjera që lidhen me kërkesat e kohës si për shembull Bazat e Inovacionit në Territor. Kjo e fundit mund të ofrohet nga pedagogët ekzistues të cilët janë trajnuar nga projektet ERASMUS+Capacity Building. Përmendim këtu Projektin SMART-AL dhe përgatitja e moduleve që lidhen me inovacionin</p>

	<p>dhe projektet në zhvillimin rural. Përfshirja e këtyre koncepteve të përshtatura për këtë cikël studimi mund të ndikojë në përmirësimin e njohurive dhe përshtatjen e tyre me nevojat e tregut.</p> <p>- <i>SHTOJCA TABELA PERMBLEDHESE PER PROGRAMIN E STUDIMIT</i></p> <p>- <i>SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p> <p>- <i>SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 2. Përmbajtja e programit të studimit është aktuale, i plotëson kërkesat e veçanta të profesionit dhe kërkesat për aftësitë shprehite e kërkuara/të pritshme nga punëdhënësit.</p>	<p>GVJ gjykon që programi i studimit duhet të aktualizohet me nevojat e kohës në tregun e punës jo vetëm duke pasur parasysh trendet e zhvillimit lokal por edhe atij global.</p> <p>Procesi i integritit të Shqipërisë drejt Bashkimit Europian në fushën e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe objektivat e mijëvjeçarit (MSDG), -Green Deal-Marrëveshja e Gjelbër Evropiane një paketë e parashikuar deri në vitin 2050, e cila synon impakt neutral të aktiviteteve bujqësore në mjedis duhet të jenë më në fokus gjatë dizenjimit të programit të studimit.</p> <p>GVJ rekomandon që lëndë si Menaxhim Agrobiznesi, Politikat e Menaxhimit të Agrobiznesit mund të shkrihen në një lëndë të vetme për të krijuar mundësinë e përfshirjes së lëndëve që lidhen me praktikën e mira mjedisore në menaxhimin e bizneseve bujqësore.</p> <p>- <i>SHTOJCA TABELA PERMBLEDHESE PER PROGRAMIN E STUDIMIT</i></p> <p>- <i>SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p> <p>- <i>SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 3. Përmbajtja parashikon zhvillimin e aftësive të transferueshme, e shtrirë edhe në modulet e përmbajtjes së tyre, gjatë zhvillimit të kurrikulës dhe në metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.</p>	<p>Si është përmendur shpesh herë në këtë raport, GVJ vlerëson që programi i studimit duhet të aktualizohet dhe përshtatet me nevojat e studentëve që targeton. Aktualizimi i programit të studimit dhe përfshirja e moduleve të tjera është një mundësi.</p> <p>Referuar dosjes së programit të studimit, përkatësisht përmbajtjes së tij, GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të programit të studimit, studentët zhvillojnë aftësi profesionale nëpërmjet ndërthurjes së elementeve të studimit teorik dhe formave të kontrollit të vazhdueshëm/praktik profesionale. Metodën kryesore të mësimdhënies janë leksione, kontrolli i vazhdueshëm/praktike profesionale. Vlerësimi i lëndëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme Po kështu, kontrolli i njohurive në një pjesë të moduleve është 70% provim me shkrim dhe 30% vlerësime të marra gjatë semestrit (psh lënda Bazat e Ekonomisë ,Prodhim Shtazor). Megjithatë, nga analiza e lëndëve të programit të studimit një pjesë e konsiderueshme e moduleve aplikojnë kontrollin e dijeve sipas skemës 50/50. Provimi me shkrim përbën 50% të notës finale dhe pjesa praktike me detyra, projekte zë pjesën tjetër.</p> <p>Në programin e studimit ofrohen tre module që lidhen me proceset dhe aktivitetet e marketingut, më konkretisht, Bazat e Marketingut, Çmimet e Produkteve Bujqësore dhe Marketing Agrar.</p>

	<p>GVJ gjykon që për natyrën e programit të studimit, lëndët e përmendura më sipër mund të bashkohen në një të vetme duke krijuar kështu mundësinë e përfshirjes së lëndëve që lidhen me marketingun e territorit dhe integrimin e zhvillimit të agroturizmit. Trendi i zhvillimit të turizmit në rajonin e Korçës lidhet ngushtë me produktet lokale bujqësore prandaj dhe përfshirja e tyre do tu ofrojë studentëve njohuri të përditësuara me trendet aktuale të zhvillimit. Gjithashtu, është e rëndësishme që studentët të përfitojnë njohuri teorike dhe praktike në lidhje me aspektet e cilësisë së produkteve bujqësore nëpërmjet praktikave të mira bujqësore si dhe certifikimet e ndryshme të cilat janë të nevojshme për specifikat e zhvillimit të zonës (si psh produkte organike, produkte green etj).</p> <p>Aspektet e cilësisë dhe certifikimet janë të rëndësishme për sa i përket tregjeve ndërkombëtare për eksporte por edhe tregut lokal (si psh treguesit gjeografikë të origjinës). Këto aspekte teorike dhe praktike është e këshillueshme të reflektohen në programet mësimore dhe syllabuse. Ndërthurja e konceptit të inovacionit me marketingun e territorit mund si dhe koncepte që lidhen si dhe përmirësimet e programit të studimit mund të zgjerojnë bazën e studentëve të targetuar nga ky program studimi. Programi i studimit mund të bëhet atraktiv edhe për punonjës të diplomuar në fusha të ndryshme.</p> <p>Multidisiplinariteti është një nevojë e kohës për tu përshtatur me ndryshimet e vazhdueshme jo vetëm në tregun e punës lokal por edhe atë ndërkombëtar. Dizenjimi i një programi atraktiv do ti japë mundësinë IAL-së ta promovojë dhe të rekrutojë edhe profesionistë që punojnë në fushën e menaxhimi të biznesit bujqësor.</p> <p>- <i>SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i> - <i>SHTOJCA PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 4. Modulet dhe aktivitetet e formimit teorik e praktik/punë konkrete mundësojnë përfitimin e njohurive, aftësive dhe shkathtësive ndërkurrikulare, të menduarit kritik, zgjidhjen e problemeve në kontekste konkrete, komunikimin dhe marrëdhëniet me të tjerë, si dhe orientimin cilësor në përvojën e punës.</p>	<p>Si është përmendur edhe në kriterin 2 dhe 3 të këtij standarti nevojitet një rifreskim i njohurive praktike dhe teorike që mundëson përfitimin e njohurive të përditësuara me kontekstin e ri të krijuar (Përafrimi i legjislacionit me BE, MSDG, Green deal). Rishikimi i tyre do të rrisë cilësinë dhe mund të ndikojë në rritjen e qëndrueshmërisë së programit të studimit dhe të tërheqë studentë më cilësorë duke pasur parasysh që aktualisht mesatarja e studentëve të përzgjedhur është e ulët.</p> <p>Në kriterin 3 të Standartit 1.1 paraqitet që, Fakulteti i Bujqësisë, ofron ofron në ciklin e parë diplomë në “Menaxhim Agrobiznesi” dhe në ciklin e dytë “Master Profesional në Zhvillim Rural të Integruar”. Këto programe studimi janë një mundësi e mirë për të ofruar një qasje holistike të kompetencave që ofron njësia bazë në nivele të ndryshme. Por njësia kryesore duhet të bëjë më shumë përpjekje për të ndërthurur njohuritë në të tre nivelet duke evituar mbivendosjet e njohurive dhe kompetencave me diplomën profesionale dhe njëkohësisht të ofrojë njohuritë të reja të cilat janë nevojë e kohës dhe që aktualisht nuk ofrohen. IAL ka të gjitha mundësitë që ti ofrojë modulet sepse disponon stafin e trajnuar në këtë drejtim. Rekomandimet janë dhënë në drejtim të shkrijës dhe përfshirjes së moduleve që lidhen me</p>


	<p>menaxhimin mjedisor, inovacionin, marketingun e territorit etj.</p> <p>- <i>SHTOJCA 3.8 ANALIZA VJETORE E VEPRIMTARISE SE NJESISE BAZE</i></p> <p>- <i>SHTOJCA PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p> <p>- <i>SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT</i></p>
<p>Kriteri 5. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.</p>	<p>Rajoni i Korçës është një rajon i rëndësishëm për peshën që zë në Produktin Bujqësor në vend. Zë 11% të sipërfaqes bujqësore në nivel vendi, ndodhen 12% e fermave. Pjesa me e madhe e fermave (85%) nuk i kalojnë 2 ha dhe vetëm 0,4% kanë me shume se 4ha. 60% e popullsisë jeton në zonat rurale (Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2016).</p> <p>Duke u nisur nga shifrat për rolin e sektorit bujqësor në rajonin e Korçës dhe për potencialin e punësimit të të rinjve në këtë sektor, GVJ vlerëson që programi i studimit në shqyrtim është një nevojë e kohës. Por duhet të reflektojë përmirësime të vazhdueshme që lidhen me një kontekst të:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Perspektivës së anëtarësimit në BE ▪ Transformimit të politikave publike ▪ Europianizimit të politikave bujqësore ▪ Adoptimit i formave agroekologjike të prodhimit, transformimit dhe tregtimit etj. <p>Si dhe problematikave që lidhen me specifikat shqiptare të sektorit bujqësor dhe blegtoral:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Trashëgimia agrare,ekonomi e specializuar në pemëtari dhe produkte pastorale ▪ Model organizimi institucional/social ndryshe nga ai i Bashkimit Evropian ▪ Ferma shume të vogla pluri-aktive ▪ Territor kryesisht malor <p>Këto elementë duhet të konsiderohen vazhdimisht në dizenjimin dhe përshtatjen e programit të studimit. Në këtë kontekst, bashkëpunimi me të gjithë aktorët vendorë që lidhen direkt ose indirekt me sektorin bujqësor jo vetëm në rajonin e Korçës por edhe me gjerë, bëjnë të domosdoshme institucionalizimin e përfshirjes e aktorëve. Ky proces duhet të bëhet jo vetëm në drejtim të realizimit të detyrimeve të praktikës për përmbushjen e detyrimeve nga ana e studentëve por edhe në drejtim të dizenjimit të programit të studimit në të ardhmen. Nga takimi me Dekanin e Fakultetit të Bujqësisë u përmend që programet e studimit në këtë drejtim shpesh herë bëhen edhe me sugjerimet e aktorëve në qeverisjen vendore. Por si u përmend edhe më sipër, GVJ rekomandon që këto procese të dokumentohen dhe institucionalizohen.</p> <p>Po kështu GVJ rekomandon një bashkëpunim më të intensifikuar me shkollat e mesme bujqësore në vend pasi ato mund të drejtojnë nxënësit e tyre në ndjekjen e një diplome profesionale që lidhet ngushtë me njohuritë e marra.</p> <p>- <i>SHTOJCA 3.5 TABELA E INSTITUCIONEVE BASHKEPUNUESE PER PRAKTIKAT</i></p>

- SHTOJCA 3.6 RAPORTI I PERFITIMEVE NGA MARREVESHJET NE FUNKSION TE PROGRAMIT TE STUDIMIT				
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

3 MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional përmes politikave e udhëzimeve të posaçme dhe mbështetet në metodat dhe praktikat më të mira të fushës	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues të posaçëm, ngre struktura të posaçme dhe zhvillon mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies dhe metodave të përdorura dhe aftësive të stafit të angazhuar, duke përfshirë aktivisht studentët në këtë proces. Rezultatet e këtyre vlerësimeve bëhen publike.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita e kryer në Institucion, vërehet se UK ka hartuar udhëzues të posaçëm dhe ka zhvilluar mekanizma të vlerësimit e të monitorimit të cilësisë së mësimdhënies, duke patur parasysh edhe situatën pandemike të dy viteve të fundit nëpërmjet formularëve të vlerësimit.</p> <p>Në këtë proces janë të përfshirë pedagogët edhe studentët. Hartimi i udhëzuesve dhe ngritja e strukturave përkatëse është rregulluar nëpërmjet Statutit të Institucionit, Rregullores së Institucionit, Rregullores së Senatit Akademik, Udhëzimit për Miratimin e Teksteve Mësimore në Nivel të Njësisë Bazë, si dhe Rregullores së Drejtorisë së Kurrikulave, Sigurimit të Cilësisë dhe Kërkimit Shkencor, reflektuar në Nenin 3, pika 2 për ngritjen e strukturës përkatëse (Sektorin e Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni) si dhe në Nenin 6, pika 8, për monitorimin e cilësisë (shih Shtojcën 1.5). Monitorimi i cilësisë së mësimdhënies pasqyrohet në raportet e vlerësimit të kryer nga NJSBC-ja (Shojca, 3.7). Gjithashtu, monitorimi i cilësisë është rregulluar nëpërmjet Manualit të Cilësisë i cili përcakton hapat, detyrat dhe strukturat për garantimin e cilësisë në mësimdhënie (Shtojca 3.16). Studentët përfshihen në këtë proces nëpërmjet pyetësorëve (Shtojca 3.13). Përfshirja e studentëve në monitorim kryhet edhe nëpërmjet përfaqësimit të një studenti në NJSBC (Shtojca 3.4). Publikimi i të dhënave të monitorimit së cilësisë dhe aspekteve të tjera në raport me studentët dhe jo vetëm është rregulluar nëpërmjet Manualit të Sistemit Elektronik ESSE3 (Shtojca 1.6). Gjithashtu, sipas stafit të UK që morën pjesë në takimet e organizuara gjatë vizitës në Institucion të dhënat e nxjerra nga aktivitetet monitoruese për cilësinë por jo vetëm publikohen në</p>



	<p>faqen zyrtare të institucionit.</p> <p>Sidoqoftë, gjatë takimeve dhe nga konstatimet u vërejt se faqja zyrtare e institucionit nuk funksionon siç duhet për shkak të disa ngërçeve teknike në raport me AKSHI-n. Aktualisht në funksionalitet të plotë është faqja e Facebook e institucionit dhe departamentit përgjegjës për programin në proces akreditimi.</p> <ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 1.1 STATUTI I UK - SHTOJCA 1.11 RREGULLORE E SENATIT AKADEMIK - SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK - SHTOJCA 1.16 MANUALI I CILËSISË UK 2020 - SHTOJCA 3.13 PYETESORI STUDENTOR - SHTOJCA 3.7 RAPORTET VJETORE TE NJS.B.C - SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA) - SHTOJCA 1.12 UDHËZIM PËR MIRATIMIN E TEKSTEVE MËSIMORE NË NIVEL NJËSIE BAZË - SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3. - SHTOJCA 3.14 PYETESORI I STAFIT AKADEMIK
<p>Kriteri 2. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/eseja, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni e që është e përshtatshme për realizimin e programit të studimit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL, vërehet se IAL UK ka përfshirë të gjitha format e mësimdhënies e mësimnxënies siç janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra e kursit/kuize, praktikat profesionale, orët e hapura, të paraqitura në planin mësimor dhe në syllabuset përkatëse (shih referencat më poshtë). Këto elementë janë të dokumentuar dhe paraqitur pranë ASCAL. Përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, pra në auditor, Institucioni ka ndërmarrë edhe formën online të mësimdhënies, në përgjigje të situatës pandemike të krijuar nga Covid19. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur pranë ASCAL si dhe nga takimet në Institucion, vërehet se janë parashikuar dhe ndërmarrë edhe orët e hapura siç është reflektuar në Shtojcën 3.18. Përveç aftësisimit teorik Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme me aktorë jashtë Institucionit për aftësim praktik në institucione rajonale që kanë bujqësisë dhe ushqimin në fokus të tyre (shih Shtojcën 2.10).</p> <ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 3.16 MODEL MESIMI ON-LINE - SHTOJCA 3.18 SHEMBULL I OREVE TE HAPURA - SHTOJCA 2.10 MARREVESHJE BASHKEPUNIMI NE MBESHTETJE TE PRAKTIKAVE PROFESIONALE - SHTOJCA 2.13 TABELA PERMBLEDHESE PROGRAMI I PRAKTIKES PROFESIONALE MESIMORE
<p>Kriteri 3. Personeli akademik përdor forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.</p>	<p>Siç është përmendur dhe më lart, përveç metodave tradicionale të mësimdhënies, pra në auditor, Institucioni ka ndërmarrë edhe formën online të mësimdhënies, në përgjigje të situatës pandemike të krijuar nga Covid19. Gjithashtu, nga dokumentacioni i paraqitur pranë ASCAL si dhe nga takimet në Institucion, vërehet se janë parashikuar dhe ndërmarrë edhe orët e hapura siç është reflektuar në Shtojcën 3.18. Përveç aftësisimit teorik Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme me aktorë jashtë Institucionit për aftësim praktik që është e rëndësishme për vetë karakteristikën e programit</p>

	<p>të studimit (shih Shtojcën 2.10). Marrëveshjet e bashkëpunimit konsistojnë kryesisht me institucione të ndryshme rajonale që operojnë në fushën e bujqësisë siç janë Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore (QTTB) Korçë, Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor (AREB), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) etj të cilat mundësojnë studentët të njihen nga ana praktike si realizohet kërkimi i aplikuar, si transferohet njohuria tek fermerët etj (Shtojca 2.10).</p> <ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 3.16 MODEL MESIMI ON-LINE - SHTOJCA 3.18 SHEMBULL I OREVE TE HAPURA - SHTOJCA 2.10 MARREVESHJE BASHKEPUNIMI NE MBESHTETJE TE PRAKTIKAVE PROFESIONALE
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies, përfshirë ato interaktive e gjithëpërfshirëse, sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL dhe nga diskutimet me stafin akademik dhe studentët vërehet se stafi akademik është i kualifikuar dhe kompetent për të përdorur metoda alternative dhe inovative për mësimdhënie dhe transmetimin e dijeve. Bazuar në CV-të e stafit të programit të dorëzuar në ASCAL stafi i angazhuar në programin e studimit paraqet eksperiencë të gjatë në mësimdhënie, janë të pajisur me grada shkencorte dhe gjithashtu janë të involvuar në kërkim shkencor i cili rrit cilësinë e mësimdhënies me te rejat më të fundit të fushave dhe tematikave specifike. Nga takimet me stafin akademik u vërejt se një pjesë e mirë e stafit është angazhuar në mësimdhënie dhe në programe shkëmbimi jashtë vendit nëpërmjet programeve të ndryshme të bashkëpunimit ndërkombëtar.</p> <ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.9. JETESHKRIMET E STAFIT TE PERFSHIRE NE PROGRAMIN E STUDIMIT - SHTOJCA 2.10 MARREVESHJE BASHKEPUNIMI NE MBESHTETJE TE PRAKTIKAVE PROFESIONALE
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të mbështesë stafin përmes njohjes me shembujt e praktikave të mira, të nxisë dhe të inkurajojë personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL dhe nga diskutimet me stafin akademik vërehet se stafi akademik inkurajohet dhe mbështetet të zhvillohet dhe përmirësojë cilësinë e mësimdhënies duke u angazhuar në aktivitete të ndryshme dhe projekte ndërkombëtare që do të çonin në përmirësimin e kurikulës dhe teknikave të mësimdhënies. Një shembull konkret që u përmend në takimet me stafin e programit është pjexsëmarrja e disa nga pjesëtarët e stafit në projektin SMART AL i cili synon të hapë një programi të ri Masteri Ekzekutiv për zhvillim territori si dhe kapacitim për përmirësimin e kurikulave. Stafi nxitet të marrë pjesë në mobilitete mësimdhënieje në institucione ndërkombëtare në bazë të marrëveshjeve institucionale të bashkëpunimit (Shtojca 2.19).</p> <ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE

	STUDIMIT - SHTOJCA 2.9. JETESHKRIMET E STAFIT TE PERFSHIRE NE PROGRAMIN E STUDIMIT - SHTOJCA 2.19 MOBILITETE STAF ERASMUS		
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.2

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike të nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Procesi mësimor teorik e praktik, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.	Bazuar në vizitën e kryer pranë institucionit vërehet se Institucioni ka në shërbim të veprimtarisë akademike dhe kërkimore shkencore mjedise bashkëkohore për zhvillimin e leksioneve, seminareve dhe orëve laboratorike në të gjithë fakultetin e bujqësisë si dhe të kampusit Universitar. Sipas stafit akademik, Programi i studimit në “Menaxhim Biznesi Bujqësor” zhvillon aktivitetin e tij akademik kryesisht në godinën e Fakultetit të Bujqësisë, i cili është ka në dispozicion një sipërfaqe prej 3006 m2, si dhe një infrastrukturë moderne me kushte të bashkëkohore për mësim dhe veprimtari shkencore: 4 auditore, 12 klasa për seminare, 9 laboratore dhe 1 bibliotekë, me rreth 22,000 tituj në gjuhë të ndryshme etj (Shtojca 2.5). Sallat e vizituara janë të pajisura me projektorë dhe pajisje të tjera IT.
Kriteri 2. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor, si dhe sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuara.	Nga vizita në mjediset e Institucioni u vërejt se infrastruktura e universitetit ku programi kryen procesin mësimor është me parametra bashkëkohore dhe përmban salla të madhësive të ndryshme. Gjatë kohës së vizitës në institucion, disa mjedise të fakultetit të bujqësisë, pjesë e të cilit është edhe programi, ishte duke u rinovuar.
Kriteri 3. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.	Gjatë vizitës në disa nga laboratorët e fakultetit u pa që laboratorët ishin të pajisur mirë me aparatura moderne (në një nga laboratorët kishte dhe një Gas-Kromatograf e cila është një pajisje e rëndësishme dhe domosdoshme për të kryer analiza të detajuara për produkte ushqimore.
Kriteri 4. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.	Gjithashtu, Fakulteti i Bujqësisë disponon një hapësirë për zhvillimin e praktikave mësimore dhe kërkimit shkencor (quket Ekonomia Didaktike Eksperimentale – EDE) Në funksion të zhvillimit të aktiviteteve kërkimore (Shtojca 4, shih gjithashtu Shtojcën 2.5, fq, 23).
Kriteri 5. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.	Në çdo program lëndor pasqyrohet literatura bazë dhe ajo e rekomanduar për përvetësimin e lëndës, të miratuar në departament. Në pjesën më të madhe të programeve të studimit, pedagogët titullarë kanë hartuar ciklin e leksioneve që u vihet në dispozicion studentëve. Një pjesë e lëndëve kanë gjithashtu literaturë të hartuar në formën e skripteve (dispencave) nga vetë pedagogët e departamentit.
Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	Institucioni (UK) ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit

akademik platform IT për mësimdhënie dhe aktivitete të tjera akademike. Ndër më kryesorët mund të përmendimin sistemi digjital të ruajtjes së të dhënave ESSE3 (Shtojca 1.6), i krijuar në kuadër të marrëveshjes me RASH (Shtojca 1.6.1). Kjo platformë mundëson komunikimin mes pedagogëve dhe studentëve në lidhje me informacionin bazë lëndor dhe elementët e vlerësimit në të. Sipas përgjegjësit të IT, aksesi në të mund të bëhet nëpërmjet faqes së internetit të UNIKO nga çdo mjet i TIK që ka lidhje internet.

Gjithashtu stafi akademik dhe studentët shfrytëzojnë platformat online të vënë në dispozicion nga UNIKO për mësimdhënien dhe konsultime online. (TEAMS, Google classroom, etj.) (Shtojca 2.18).

Pjesë e burimeve të shfrytëzueshme të UNIKO është edhe libraria online "U-LIBRARY", e cila siguron një tjetër mundësi për përditësimin dhe përmirësimin e materialeve mësimore që u vihen në dispozicion studentëve.

Sidoqoftë, GVJ është i mendimit se edhe pse infrastruktura bazë për aksesin online egziston, cilësia e materialeve online ka nevojë të përmirësohet dhe të përditësohet me materiale bashkëkohore që të reflektojnë zhvillimet më të fundit në fushën e bujqësisë.

Infrastruktura laboratorike (Shtojca 4) është në mbështetje të zhvillimit të orëve laboratorike dhe detyrave të ndryshme dhe lejon akses për mënyra të ndryshme ndërveprimi. Studentët kryejnë praktika mbështetur edhe në rregulloren për sigurimin teknik në laborator. (Shtojca 2.17).

- SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT

- SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT

- SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3.

- SHTOJCA 1.6.1 MARRËVESHJE RASH PËR ESSE3.

- SHTOJCA 2.17 RREGULLORE E SIGURIMIT TEKNIK NE LABORATOR

- SHTOJCA 2.18 MANUAL PER MESIMIN ON-LINE.

- SHTOJCA TABELA PERMBLEDHESE PER PROGRAMIN E STUDIMIT

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat garantojnë cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit dhe rritjen e vetëdijes për përmirësimin e tyre

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që ndjekin, vlerësojnë dhe monitorojnë procesin e mësimdhënies dhe koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së saj.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL dhe nga vizita e kryer në institucion, vërehet se janë ngritur struktura dhe njësi që kanë përgjegjësi për monitorimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor. Një nga strukturat kryesore për këtë proces është Sektori i Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, (Shtojca 1.5) i cili është funksionon brenda Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional, që harton planin vjetor të veprimtarisë (Shtojca 1.5.1) dhe është përgjegjës për monitorimin dhe rishikimin e programeve të studimit. Këto struktura dhe njësi janë parashikuar në statutin e institucionit si dhe në rregulloret kryesore institucionale (Shtojca 1.1).</p> <p>Në kuadër të monitorimit të procesit mësimor funksionon edhe NJSBC, e cila nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të procesit mësimor, evidenton problematikat kryesore të lidhura me kurrikulat, si dhe bën të mundur sigurimin e bazës së të dhënave për cilësinë e mësimdhënies. Struktura përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie (në këtë rast NJSBC) pasi përpunon rezultatet e vlerësimit i komunikon ato tek autoritetet drejtuese të UNIKO siç është parashikuar në rregulloren e institucionit dhe në statut. Në bazë të takimeve në institucion dhe nga dokumentacioni i dorëzuar mund është vërejtur një angazhim i stafit akademik të programit të studimit nën akreditim për të u përfshirë në bashkëpunime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat ndikojnë pozitivisht në rritjen e kapaciteteve dhe cilësisë të mësimdhënies duke u ekspozuar ndaj metodave inovative të mësim dhënies si dhe literaturës përkatëse të kohëve të fundit. Nga diskutimet u pa që këto inisiativa mbështeten nga njësia bazë e cila bën përpjekje të vazhdueshme në drejtim të përmirësimit dhe përditësimit të literaturës për lëndët përkatëse dhe avancimit në drejtim të kërkimit shkencor, si dhe botimit të teksteve të stafit akademik duke i miratuar në departament sipas përcaktimeve të akteve të brendshme të UNIKO (Shtojca 1.12).</p> <p>Gjithashtu, liria akademike në drejtim të organizimit të orëve mësimore sipas nevojave dhe mundësive të studentit i jep mundësi pedagogut që të aplikojë forma ndërveprimi që nxisin të menduarit kritik mbi çështje të caktura. Përdorimi i pajisjeve audiovizuale interaktive, diskutimet në grup, dhe role të ndryshme, janë veprimtari që pasurojnë procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p>Përsa i përket metodologjisë në mësimdhënie ka përpjekje nga institucioni për të vënë fokusin në pjesëmarrje aktive të studentëve (Shtojca 3.16). Këto forma e ndihmojnë studentin të fitojë njohuri mbi fushën. Metodatat e përdorura kanë në qendër të tyre sesione me ligjërata, seminare, punë praktike, punë laboratorike, projekte, vizita studimore,</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies, cilësinë e saj dhe rritjen e vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja, në përputhje me natyrën dhe specifikën e programeve profesionale.</p>	
<p>Kriteri 4. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies përmes trajnimeve të vazhdueshme të personelit akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të tyre.</p>	
<p>Kriteri 5. Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	


	ekskursione etj.		
	- SHTOJCA 1.1 STATUTI I UK. - SHTOJCA 1.11 RREGULLORE E SENATIT AKADEMIK. - SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK. - SHTOJCA 1.16 MANUALI I CILËSISË UK 2020 . - SHTOJCA 3.16 MODEL MESIMI ON-LINE. - SHTOJCA 3.17 MODEL ANALIZA NE PERFUNDIM TE NJE MODULI		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X	

Standardi III.4	
Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme për vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën për çdo student.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, të cilat bëhen publike. Institucioni mban dhe ruan dokumentacionin e vlerësimeve, ankimimet dhe rishqyrtimet e vlerësimit, sipas afateve e procedurave në rregulloret përkatëse.	GVJ konstaton nga takimi me studentët, se ata informohen nga stafi akademik në fillim të semestrit për: programin e lëndës, format alternative të vlerësimit si dhe detyrimet që studentët kanë. Referuar rregullores së programit, syllabuseve dhe informacionit të siguruar nga stafi akademik dhe studentët, rezultojnë se në syllabus janë parashikuar format e vlerësimit, masa e vlerësimit të çdo komponenti. GVJ gjykon që ka një diversitet sa i përket mënyrës së kontrollit të njohurive në lëndë të ndryshme që ofrohen në kuadër të programit të studimit. Duke marrë në shqyrtim syllabuset e lëndëve vihet re që edhe pse ka një diversitet në format e kontrollit të njohurive, GVJ gjykon që format e ndryshme nuk janë konform rregullit 50/50. Disa shembuj të lëndëve po i paraqesim më poshtë.
Kriteri 2. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	
Kriteri 3. Në fillim të çdo lënde/moduli, studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës /modulit.	<ul style="list-style-type: none"> • Matematikë e Aplikuar –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit. • Komunikim Biznesi - Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit. • Mbledhje dhe Përpunim të Dhënash - Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Kuize 5-25%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit. • Bazat e Kontabilitetit - Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Kuize 5-25%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
Kriteri 4. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik, duke venë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat garantojnë anonimat, eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	
Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisione provimi, shoqërohet me komente e këshilla mbi	

procesin e të nxënimit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.

Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse, duke garantuar njëkohësisht të drejtat e studentëve, për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me këto rregullore.

- **Prodhim Shtazor** – Kontributi i studimeve gjatë semestrit në notën përfundimtare **30%**, kontributi final në notën përfundimtare **70%**
- **Gjuha Angleze** - Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Projekte 1-30%, Pjesëmarrja në mësim 10%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Bazat e Ekonomisë** –Kolokium **15%**, Kuize **5%**, Detyra Projekte **10%**, Lënda do jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Bazat e Marketingut** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Çmimet e produkteve bujqësore** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 15%, Kuize 5%, Detyra/Projekte 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Bazat e Prodhimit Bimor** –ka ndarje 50/50 në ngarkesën mësimore. Temat janë ndërtuar në 2 orë teori dhe 2 orë praktikë/laborator. Mënyra e kontrollit të dijeve nuk është dhënë.
- **Laborator Informatike** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Menaxhim Agrobiznesi** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Politika e menaxhimit të biznesit** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 2-40%, Projekte 2-8%, Aktivizim në mësim 13-26%, Të tjera-pjesëmarrje në mësim 13-26%. Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Menaxhim i Burimeve Njerëzore** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-10%, Pjesëmarrje në mësim 1-10%, Provim përfundimtar 70%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të vitit.
- **Ekonomi Bujqësore** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 15%, Kuize 10%, Projekte/Detyra 5%, Pjesëmarrje në mësim 10%, Provim final i modulit do të jepet me shkrim në fund të semestrit 60%.
- **Menaxhim i Biznesit të Vogël**–Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 2-40%, Aktivizim në mësim 13-26%, Të tjera pjesëmarrje në mësim 13-13%, Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të semestrit.
- **Menaxhim i Mekanikës Bujqësore** – Kontrolli i vazhdueshëm: Laboratore 1-50%, Seminare 1-25%, Ushrime 1-25%, Lënda do të jepet provim me shkrim dhe gojë në fund të semestrit.
- **Drejtim Ferme** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Kuize 5-25%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%. Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të semestrit.
- **Marketing Agrar** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-50%, Kuize 5-25%, Projekte 1-15%, Detyra të tjera 10%. Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të semestrit
- **Ekstension Bujqësor** –Kontrolli i vazhdueshëm: Kolokium 1-10%, Kuize 5-25%, Projekte/Detyra 1-10%,



Pjesëmarrje në mësim 1-10%, Provim përfundimtar 1-70%.
Lënda do të jepet provim me shkrim në fund të semestrit

GVJ vlerëson që testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik nëpërmjet formave të ndryshme të përcaktuara në rregulloren e institucionit (Shtojca 1.2). Në rregulloren e institucionit përcaktohen procedurat që ndiqen për realizimin e vlerësimit të studentëve ku parashikohen dhe format e ndryshme të vlerësimit si dhe organizimin e tyre (Shtojca 1.2, Nenet 82-83, si dhe Nenet 96-103). Në nenin 103, përcaktohet gjithashtu mundësia dhe procedura e studentit të ankimojë vlerësimin.

Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL, rregullorja e njësisë bazë parashikon shpalljen e komisioneve të provimit një javë përpara provimit (shih Shtojcën 2.3, fq, 11). Rolin kryesor në përgatitjen e formave dhe procesit të vlerësimit e ka titullari i lëndës.

Përgjithësisht vlerësimet e dijeve dhe njohurive të studentëve janë të vlerësuara nga titullari përgjegjës i lëndës, dhe në rastin e provimit me gojë mund të bëhet nga titullari apo grup pedagogësh (Shtojca 1.2).

Referuar takimeve me stafin akademik dhe student, si dhe nga dokumentacioni i paraqitur pranë ASCAL; studentët informohen për mënyrën dhe format e vlerësimit në fillim të çdo lënde/moduli, nga titullari i lëndës, nga syllabuset e lëndëve, si dhe në orët e para të mësimit. Studentët marrin informacion mbi metodologjinë e testimit, vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore (Shtojca 3.11).


Gjithashtu studentët informohen mbi planin mësimor të programit të studimit, ku përcaktohet ndarja në lëndë/module, si dhe përmban emërtimin e plotë, kodin, vitin/semestrin kur zhvillohet, orët në auditor (leksione/seminare/laboratorë) etj (Shtojca 2.7). Nga vizita në institucion u vërejt se plani mësimor ishte afishuar në hollin e fakultetit të bujqësisë (kati i II-të). Sipas bisedave u mësuar se përdoret gjithashtu edhe korigjimi elektronik nëpërmjet projektit Cleanscore.

Për matjen e clësisë së mësimdhënies përdoren forma të ndryshme të vlerësimit të performancës (Shtojcat 3.13, dhe 3.17).

Institucioni ka një sistem digjital të brendshëm të menaxhimit "ESSE3" (Shtojca 1.6). Ky sistem elektronik admnistron materialet e hedhura nga stafi akademik për lëndët dhe modulet e ndryshme, materialet shtesë, pikët dhe vlerësimet e studentëve. Ai i informon studentët online për pikët dhe notat në kohë reale. Ky sistem elektronik shërben për ruajtjen e dokumentacionit dhe aktivitetit të stafit akademik.

Stafi akademik ka për detyrë: Deri në fund të muajit dhjetor, duhet të publikojë online syllabuset e lëndëve, në programet e studimit në të cilat ai jep mësim.

Kontrollon grafikun e provimeve dhe hedh rezultatat e frekuentimit dhe të vlerësimit të vazhduar për secilin student. Gjeneron rezultatet e provimit brenda afateve të përcaktuara në Manual.



	<p>Pedagogu ka hapësirën e dedikuar komenteve specifike në lidhje me vlerësimin për secilin student. Sistemi është kryesisht në funksion të mësimdhënies.</p> <p>Sistemi digjital ESSE3 siguron akses të dedikuar për Studentët, i cili përmban, librezën online të studentit, printim e elemente sigurie i listës së notave, menaxhimi i vlerësimit, menaxhimi i sistemit të krediteve etj.</p> <p>Sistemi ESSE3 kontrollon autenticitetin e informacionit identifikues të përdoruesit; autorizon aksesin e përdoruesit në të gjitha funksionet/operacionet; ruan privatësinë e të dhënave. Sistemi garanton monitorimin në kohë reale të një sërë aktiviteteve për mbarëvajtjen e procesit akademik përmes një sërë statistikash përshkruese të gjeneruara prej tij. Këto statistika i vihen në dispozicion Përgjegjësit të departamentit, organeve drejtuese dhe personave të tjerë përgjegjës për monitorimin e ecurisë së procesit mësimor.</p> <p>- SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK - SHTOJCA 2.3 RREGULLORE E NJESISE BAZE - SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT. - SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT. - SHTOJCA 2.15 PYETJET E PROVIMIT TE PROVIMIT. - SHTOJCA 3.13 PYETESORI STUDENTOR. - SHTOJCA 3.17 MODEL ANALIZA NE PERFUNDIM TE NJE MODULI. - SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Në përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Zhvillimi i programit të studimit, deri në diplomim, garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët duke dhënë njëkohësisht njohuri të aplikuara dhe kompetenca profesionale lehtësisht të përdorshme në tregun e punës, apo për studime të mëtejshme.

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë përfundimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe të veçanta të studentëve, që janë në përputhje me rezultatet e pritura të të nxënësve për programet me karakter profesional.</p>	<p>Nga vizita në institucion me stafin akademik dhe studentë, si dhe nga dokumentacioni i dorëzuar pranë ASCAL u konstatua se metodat e përdorura, janë në funksion të thellimit të njohurive të studentëve. Në leksione dhe seminare, synohet aktivizimi i studentëve, nëpërmjet kuizeve, rasteve studimore, ditëve të hapura, detyrave të kursit, për të zhvilluar aftësitë profesionale të studentëve (Shtojca . Megjithatë GVJ gjykon që lëndët e propozuara në programin e studimit diplomë profesionale, tejkalojnë nevojat e studentëve për një profil programi profesional.</p> <p>GVJ rekomandon rishikim të programit të studimit jo vetëm në terma të lëndëve të përfshira por edhe mënyrës së ofrimit të dijeve duke pasur parasysh që diploma profesionale duhet të</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton njohuritë e përshtatshme dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave apo çështjeve të caktuara.</p>	

<p>Kriteri 3. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale, duke garantuar realizimin në praktikë të marrëveshjeve me punëdhënësit e aktorët e biznesit në përfitim të formimit praktik të studentëve. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar formimin cilësor dhe për të nxitur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>ketë një raport midis teorisë dhe praktikës në raportet 50/50. Mënyra se si janë ndërtuar syllabuset targetojnë student të ciklit të parë të studimeve universitare BSc. Për shembull lënda e matematikës së aplikuar është shumë e avancuar për nivelin e studentëve dhe për qëllimin e një diplomë profesionale. Temat dhe literatura e ofruar janë të marra nga literature dizenjuar për fakultetin ekonomik (Algebra për Fakultetin Ekonomik) (Shih Shtojcën 2.8).</p> <p>Për sa i përket praktikës laboratorike, nga vizita në institucion në mjediset laboratorike si dhe nga bisedat me studentët e dy viteve u vërejt se institucioni ka hapësira dhe pajisje funksionale për realizimin e orëve laboratorike, për modulet specifike që parashiokjnë orë laboratorike.</p>
<p>Kriteri 4. Në përfundim të çdo moduli apo lënde, personeli akademik vlerëson, analizon e shqyrton kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, duke nxjerrë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orientojnë studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Gjithashtu GVJ vëren se institucioni ka nënshkruar marrëveshje të ndryshme bashkëpunimi për formësimin praktik të studentëve me institucione si QTTB (Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore) Korçë, AREB (Agjencia Rajonale e Ekstensionit Bujqësor) Korçë, të cilat janë institucionet e duhura dhe të përshtatshme për kryerjen e praktikave mësimore në terren, te cilat merren direkt me fermerët në aspektin zbatues (Shtojca 2.10).</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni harton procedura të posaçme, të njohura e publike për diplomimin e studentëve dhe garanton mbështetjen dhe udhëzimin e studentëve në procesin e diplomimit. Ai mban regjistra zyrtarë të studentëve të diplomuar dhe i përditëson ata në fund të çdo viti akademik.</p>	<p>Për të analizuar kompetencat dhe aftësitë e fituara nga studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, GVJ vëren se institucioni ka rregullore dhe mekanizma vlerësimi të cilat nxjerrin në pah problematikat e ndryshme si dhe për të orientuar studentët për zbatimin e tyre.</p>
<p>Kriteri 6. Njësia përgjegjëse, personeli akademik dhe udhëheqësit akademikë orientojnë dhe ndihmojnë studentët për përgatitjen e punimit të diplomës, realizimin e veprimtarisë praktike dhe përpunimit të rezultateve, duke garantuar bashkëpunimin edhe me aktorë të jashtëm për realizimin e saj.</p>	<p>Në të njëjtën kohë, edhe rregulloret e institucionit dhe programit parashikojnë këto aspekte të vlerësimit të studentëve (Shtojca 2.5). Njësia bazë dhe stafi akademik analizon në mënyrë periodike ecurinë e punës dhe rregullon procesin e vlerësimit për provimet finale të moduleve (shih Shtojca 2.3 dhe Shtojca 3.17). Në analizën periodike kërkohet nga pedagogu i çdo lënde pasqyrim i objektivave të arritura dhe rekomandimet në lidhje me të ardhmen (shih Shtojca 3.7).</p> <p>Nga diskutimet me stafin akademik dhe studentë gjatë vizitës në institucion u shpreh se stafi akademik/pedagogu pas përfundimit të çdo lënde realizon seancë konsultimi me studentët për çështjet kryesore të trajtuara dhe e orientojnë studentin drejt provimit përfundimtar.</p> <p>Bazuar në rregulloren mësimore të programit të studimit (Shtojca 2.5) parashikohet që njësia bazë të ndjekë një procedurë të posaçme për studentët që japin provimin final ose mbrojnë diplomën (Shtojca 2.14). Anëtarët e stafit akademik depozitojnë pranë përgjegjësit të njësisë bazë një grup pyetjesh (fond pyetjesh) për çdo lëndë/modul të tyre me qëllim që studentët të orientojnë paraprakisht në lidhje me literaturën që duket të lexojnë për t'u përgatitur për provimin final (Shtojca 2.15).</p> <p>Pas përfundimit të studimeve nga studenti, Sekretaria mësimore arkivon regjistrin zyrtar të studentëve të diplomuar. Të dhënat të plota për studentët e diplomuar gjenden në një databazë të plotë dhe në Qendrën e Karrierës dhe Alumni (Shtojca 3.20).</p> <p>Nga biseda me stafin akademik gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se programi i studimit me karakter profesional "Menaxhim Biznesi Bujqësor" ende nuk ka një</p>

	<p>praktikë të përgatitjes nga studentët të një teme diplome, kjo, sipas bisedave me stafin, për arsye se:</p> <p>a) programi ka diplomuar vetëm dy breza studentësh;</p> <p>b) viti që sapo u mbyll për shkak të pandemisë COVID 19, nuk e jetësoi një risi të tillë.</p> <p>- SHTOJCA 2.3 RREGULLORE E NJESISE BAZE.pdf</p> <p>- SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT.pdf</p> <p>- SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT.pdf</p> <p>- SHTOJCA 2.10 MARREVESHJE BASHKEPUNIMI NE MBESHTETJE TE PRAKTIKAVE PROFESIONALE.pdf</p> <p>- SHTOJCA 2.14 MANUAL PER PUNIMIN E DIPLOMES.pdf</p> <p>- SHTOJCA 2.15 PYETJET E PROVIMIT TE PROVIMIT.pdf</p> <p>- SHTOJCA 3.17 MODEL ANALIZA NE PERFUNDIM TE NJE MODULI.pdf</p> <p>- SHTOJCA 3.20 ANALIZA VJETORE QENDRA E KARRIERES E ALUMNIT.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

4 BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për përzgjedhjen dhe cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive nga ana e tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton procedura dhe kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura, që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit, në	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita e kryer në institucion, GVJ vëren se institucioni ka krijuar një set rregulloresh dhe dokumentacioni mbi të cilën ka hartuar dhe zbaton procedura dhe kriteret të ndryshme (të përgjithshme dhe specifike) me synim përzgjedhjen e personelit të duhur, sipas kërkesave të programit dhe ligjore. Në nenin 45 të Statutit të Institucionit (Shtojca 1.1) përcaktohen procedurat dhe kriteret për përzgjedhjen e personelit.

<p>përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të tij.</p>	<p>Përveç parashikimeve të përcaktuar në Statutin e universitetit, institucioni ka hartuar dhe udhëzime specifike për rekrutimin e stafit (Shtojca 1.13). Sipas takimeve të kryera gjatë vizitës në institucion me stafin akademik, u diskutua procedura e përzgjedhjes së personalit akademik, ku stafi i UNIKO shpjegoi se çdo ndryshim në lidhje me nevojat e njësisë bazë, propozohet nga Departamenti i Agrobiznesit, miratohet në Dekanat dhe i dërgohet për miratim Senatit akademik dhe Bordit të Administrimit (Shih edhe Shtojcën 1.21). Gjatë diskutimit u konstatua gjithashtu vështirësia që egzistonte në rekrutimin e personelit të kualifikuar për shkak të ofertës së limituar që përmbush kërkesat specifike krijuar nga shumë faktorë (shih dhe Minutat e Takimeve). Kjo situatë ka rëndësi të veçantë për sa i përket aspektit të qëndrueshmërisë së programit, ku u theksuar se personeli me tituj akademik Prof. Dr. është përgjithësisht i jashtëm, ndërsa mbizotëron personeli me gradë MSc i cili mbulon një numër të konsiderueshëm modulesh (Shtojca Minutat e Takimeve).</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program, personin përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, përfshirë tutorët apo vëzhguesit e praktikës në institucionet partnere, si dhe atë të personelit ndihmësimor-shkencor dhe administrativ të angazhuar.</p>	<p>Përsa i përket procedurave dhe publikimeve online të njoftimeve për vendet vakante, u theksua se këto bëhen në faqen e institucionit, si dhe në rrjetet sociale të departamentit dhe fakultetit. Ndërkohë, vlerësimi i kandidatëve bëhet duke u mbështetur në thirrjen ku përfshihen kritere të përgjithshme dhe kritere specifike që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Bazuar në Shtojcën 2.16, vërehet se përditësohen në mënyry periodike të dhënat që lidhen me aktivitetin kërkimor të stafit akademik, CV e tyre akademike, formularin e organizimit të kohës vjetore, formularët e parashikimit dhe realizimit të ngarkesës mësimore, si dhe çdo dokumentacion tjetër që i bashkëngjitet “Rregullores së programit të studimit” (Shtojca 1.14). Sipas dokumentacionit të dorëzuar, Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore administrojnë dhe përditësojnë gjithë dokumentacionin e personelit akademik (Shtojca 1.4).</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimit me karakter profesional dhe për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>GVJ konstatoi se ka një angazhim në sigurimin e cilësisë në mësimdhënie, vlerësim dhe infrastrukturë ku dhe bëhen analiza të moduleve specifike (Shtojca 3.17), programit të studimit (Shtojca 3.7) të cilat përfshihen në analizën vjetore mësimore, shkencore dhe financiare të UK (Shtojca 2.20).</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administrojnë programin e studimit, përmes organizimit të programeve specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, si dhe mbështetjen për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Nga dokumentacioni i dorëzuar vërehet se të gjithë anëtarët e këtij departamenti kanë tituj dhe grada shkencore në fushat përkatëse, (Shtojca 4 dhe Shtojca 2.9). Sidoqoftë, siç është përmendur dhe me lart, vërehen disa kufizime në personelin me kohë të plotë me tituj të lartë akademik (Prof. Dr. dhe Prof. Asoc. Dr). Është për të u përmendur që institucioni ka parashikuar dhe përcaktuar në rregullore dhe përfitim të vitit sabbatik (Shtojca 1.22).</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e depozituar pranë ASCAL si dhe nga vizita e kryer në institucion, GVJ vëren se Fakulteti i Bujqësisë së Universitetit të Korçës mbështet kualifikimin e vazhdueshëm të personelit akademik në metoda inovative mësimdhënie, reflektuar në pjesëmarrjen e tyre në projekte të ndryshme studimore dhe kërkuese si dhe shkëmbimet akademike me universitete të ndryshme perëndimore dhe sidomos me Universitetin Bujqësor të Tiranës (p.sh Projekti SmartAI, apo projekte Interreg).</p> <p>- SHTOJCA 1.1 STATUTI I UK</p>

	<ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 1.13 UDHËZIM REKTORATI PËR REKRUTIMIN E STAFIT - SHTOJCA 1.21 RREGULLORE E BORDIT TË ADMINISTRIMIT. - Minuta Korca. - SHTOJCA 2.16 FORMATI I DOSJES PERSONALE MESIMORE TE STAFIT - SHTOJCA 1.4 RREGULLORJA E DREJTORISË SË BURIMEVE NJERËZORE KOMUNIKIMIT DHE PROMOCIONIT - SHTOJCA 3.7 RAPORTET VJETORE TE NJ.S.B.C. - SHTOJCA 3.17 MODEL ANALIZA NE PERFUNDIM TE NJE MODULI. - SHTOJCA 2.20 ANALIZA E VEPRIMTARISE SE UK - SHTOJCA 1.22 RREGULLORJA E PËRFITIMIT TË VITIT SABATIK - SHTOJCA 2.19 MOBILITETE STAF ERASMUS+. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatshëm sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit me karakter profesional

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, GVJ konstaton se Institucioni disponon mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor të aspektit teorik në programin e studimit Diplomë Profesionale në Menaxhim të Biznesit Bujqësor. Institucioni disponon salla leksionesh dhe seminaresh me kapacitet të mjaftueshëm për zhvillimin normal të mësimit edhe pse njëra nga godinat e Fakultetit të Bujqësisë është aktualisht në proces rikonstruksioni (Shtojca 4).</p> <p>Gjatë vizitës në institucion u theksua se punimet për rikonstruksionin e godinës pritet të përfundojnë brenda vitit 2021.</p> <p>Fakultetit të Bujqësisë, ka në dispozicion një sipërfaqe prej 3006 m², si dhe një infrastrukturë moderne me kushte të bashkëkohore për mësim dhe veprimtari shkencore: 4 auditore, 12 klasa për seminare, 9 laboratore dhe 1 bibliotekë, me rreth 22,000 tituj në gjuhë të ndryshme etj (Shtojca 2.5). Sallat e vizituara janë të pajisura me projektorë dhe pajisje të tjera IT. Nga vizita në mjediset e Institucioni u vërejt se infrastruktura e universitetit ku programi kryen procesin mësimor është me parametra bashkëkohore dhe përmban salla të madhësive të ndryshme. Gjatë kohës së vizitës në institucion, disa mjediset të fakultetit të bujqësisë, pjesë e të cilit është edhe programi, ishte duke u rinovuar.</p> <p>Gjatë vizitës në disa nga laboratorët e fakultetit u pa që laboratorët ishin të pajisur mirë me aparatura moderne (në një nga laboratorët kishte dhe një Gas-Kromatograf e cila është një pajisje e rëndësishme dhe</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasat, laboratorët, studiot e mjediset e tjera janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas fushës specifike të programit profesional, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të</p>	

<p>studimit në tërësi.</p> <p>Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.</p>	<p>domosdoshme për të kryer analiza të detajuara për produkte ushqimore. Gjithashtu, Fakulteti i Bujqësisë disponon një hapësirë për zhvillimin e praktikave mësimore dhe kërkimit shkencor (quhet Ekonomia Didaktike Eksperimentale – EDE), e cila është në funksion të zhvillimit të aktiviteteve kërkimore si dhe praktikave mësimore (Shtojca 4, shih gjithashtu Shtojcën 2.5, fq, 23).</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale, internship-it dhe veprimtarive të tjera praktike thelbësore për programet me karakter profesional.</p>	<p>Laboratori i informatikës është i pajisur me softuerët përkatës në mënyrë që të t'i shërbejë sa më mirë programit mësimor. Ai është në parametra të mirë për realizimin e nevojave të programit të studimit në lidhje me përdorimin e teknologjisë në drejtim të përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie.</p> <p>Gjithashtu stafi akademik dhe studentët shfrytëzojnë platformat online të vënë në dispozicion nga UNIKO për mësimdhënie dhe konsultime online. (TEAMS, Google classroom, etj.) (Shtojca 2.18).</p> <p>Pjesë e burimeve të shfrytëzueshme të UNIKO është edhe libraria online “U-LIBRARY”, e cila siguron një tjetër mundësi për përditësimin dhe përmirësimin e materialeve mësimore që u vihen në dispozicion studentëve. Infrastruktura laboratorike (Shtojca 4) është në mbështetje të zhvillimit të orëve laboratorike dhe detyrave të ndryshme dhe lejon akses për mënyra të ndryshme ndërveprimi. Studentët kryejnë praktika mbështetur edhe në rregulloren për sigurimin teknik në laborator (Shtojca 2.17).</p> <p>- SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT. - SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT. - SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3. - SHTOJCA 1.6.1 MARRËVESHJE RASH PËR ESSE3. - SHTOJCA 2.17 RREGULLORE E SIGURIMIT TEKNIK NE LABORATOR. - SHTOJCA 2.18 MANUAL PER MESIMIN ON-LINE. - SHTOJCA TABELA PERMBLEDHESE PER PROGRAMIN E STUDIMIT.</p>			
<p>Shkalla e përbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p> <p>X</p>

<p>Standardi IV.3</p> <p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse e të posaçme të mësimnxënies, bibliotekën e literaturën dhe mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit dhe realizimin cilësor të tij</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit dhe krijon kushte për akses të barabartë e pa pagesë dhe të jetë e</p>	<p>Bazuar në vizitën që u krye në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, dhe nga dokumentacioni i paraqitur pranë ASCAL, u vërejt se IAL në fjalë vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, me një fond rreth 22,000 tituj në gjuhë të ndryshme etj (Shtojca 2.5). Gjatë vizitës u vërejt se Biblioteka aktualisht ishte vendosur provizorisht në një sallë leksioni pasi godina e Departamentit të Agrobiznesit ishte nën</p>

<p>pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>rikonstruksion.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë mësimore bazë, ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, të mjaftueshme dhe të përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Gjithashtu për sa i përket fondit të librave të ruajtura pranë bibliotekës provizore, vërehet se biblioteka ishte e pasur përgjithësisht me literaturë nga profesori i Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe që ishte e lidhur me programin profesional të studimit. Kjo shikohet pozitive pasi i ofron studentëve mundësinë të kenë literaturë në gjuhën shqipe. Sidoqoftë, institucioni disponon gjithashtu edhe Bibliotekën Shkencore në Rektorat, e cila i mundëson studentëve një hapësirë më të gjerë për të hulumtuar literaturën e nevojshme, sipas orareve të përcaktuara në rregullore e funksionimit të bibliotekave. Studentët mund të marrin literaturë për ta shqyrtuar edhe jashtë mjediseve të bibliotekës (Shtojca 1.5, neni 16-23). Bibliotekat janë të pajisura me tavolina, kompjutera dhe internet të cilët mundësojnë aksesin e studentëve në biblioteka online, në të cilat UNIKO kryen abonim: EBSCO7, Scopus. I gjithë procesi i shfrytëzimit të bibliotekave është pa pagesë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit dhe duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Meqënëse njësi bazë (Departamenti i Agrobiznesit) funksionon në përbërje të njësisë kryesore si dhe përfshihet në të njëjtën njësi dhe të vetme shpenzuese (UNIKO), nuk ka buxhet të individualizuar. Të ardhurat për mbarëvajtjen e programit gjenerohen kryesisht nga tarifat e studentëve, të ardhurat dytësore si dhe të ardhurat që sigurohen nga pjesëmarrja në projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare, nga ku mund të përfitohen burime financiare për fond literature apo edhe libra etj të cilat i vihen në dispozicion studentëve dhe stafit akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, përmes bashkëpunimit me aktorë të jashtëm, të angazhuar në realizimin e programit mësimor, duhet t'u lehtësojnë dhe garantojë studentëve mbështetjen dhe përdorimin e burimeve e logjistikës së nevojshme të institucioneve partnere, në varësi të natyrës së angazhimit të tyre në procesin formues teorik, praktik dhe profesional të studentëve.</p>	<p>Për sa i përket kostove financiare për programin e studimit, buxheti financiar hartohet çdo vit nga Drejtoria Ekonomike (Shtojca 1.7) dhe Drejtoria e Financës (Shtojca 1.8) në drejtimin e administratorit të UNIKO. Buxheti ndahet sipas përcaktimeve të rregullores financiare (Shtojca 1.8.1), miratohet nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit (Shtojca 3.15)</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni parashikon koston financiare të programit të studimit profesional, mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi dhe raportin financiar të përvitshëm dhe në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi.</p>	<p>Plani i financimit miratohet në nivel institucional nga Bordi i Administrimit ku përfshihen të gjitha kostot dhe të ardhurat e parashikuara. Hartimi i projekt-buxhetit afatmesëm, miratimi i tij në organet kolegjiale reflekton një radhë prioritare kronologjike të financimit të nevojave të njësisë bazë.</p>
<p>Kriteri 6. Financimi i një programi studimi profesional duhet të sigurojë e të garantojë mbulimin e të gjitha burimeve dhe veprimtarive të qëndrueshme dhe operative, të lidhura e që janë në funksion të realizimit të programit të studimit, duke garantuar njëkohësisht qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit e në vijim.</p>	<p>Gjithashtu raporti i analizës mësimore, kërkimore-shkencore dhe financiare (Shtojca 2.20) mundëson transparencë financiare dhe i jep mundësi njësisë bazë (Departamenti të Agrobiznesit) të jetë pjesë e proceseve vendimarrëse. Në mënyrë sistematike studimi i tregut të punës nga Departamenti i Agrobiznesit do të mundësojë rritjen e pritshmërive financiare në funksion të programit të studimit.</p> <p>- SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT. - SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA). - SHTOJCA 1.7 RREGULLORE E DREJTORISË EKONOMIKE. - SHTOJCA 1.8 RREGULLORE E DREJTORISË FINANCIARE (EDE). - SHTOJCA 1.8.1 RREGULLORJA FINANCIARE. - SHTOJCA 3.15 RAPORTI FINANCIAR PER KOSTOT E</p>

	PROGRAMIT TE STUDIMIT. - SHTOJCA 2.20 ANALIZA E VEPRIMTARISE SE UK.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek, zbaton politika e procedura institucionale dhe i jep formacion të plotë e të hollësishëm studentëve mbi programin e studimit me karakter profesional, pranimin, përzgjedhjen, përparimin akademik, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton, zbaton dhe bën publike politika, procedura e kriteret të qarta e të kuptueshme për pranimit e studentëve, përparimin e tyre përgjatë kursit të studimit, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit, të cilat garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, GVJ konstaton se Institucioni harton procedura dhe politika për pranimin e studentëve, si dhe për të gjithë procesin përgjatë programit të studimit. Numri i studentëve për programin në fjalë bazohet në legjislacionin në fuqi në lidhje me kuotat dhe në rregulloret e përcaktuara nga Institucioni (Shtojca 3.9) si dhe nga kërkesat e tregut të punës (Shtojca 3.12). Vizioni dhe politika e institucionit për pranimin e studentëve diktohet nga Plani Strategjik të Zhvillimit, (Shtojca 2.4), ku theksohet ruajtja e lidhjeve të vazhdueshme me insitucionet e arsimit parauniversitar me qëllim promovimin e programeve të studimit. Gjatë diskutimeve të zhvilluara gjatë vizitës në institucion, u shpreh nga stafi akademik se ndërmerren fushata informuese në shkollat e mesme kryesisht në rajonin e Korçës dhe zonave përreth, rreth ofertës së programit të studimit. Këto veprimtari informuese organizohen nga vetë departamenti, nga pedagogët, ose nga strukturat administrative në Rektorat (Shtojca 3.11). Gjatë këtyre vizitave shpërndahen broshura dhe fletëpalosje ku promovohen programi e studimit (objektivat, mundësitë e punësimit, kriteret e pranimit dhe infrastruktura në dispozicion) dhe reklamohen në media afatet dhe procedurat e aplikimit.
Kriteri 2. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të përgjithshme dhe/ose të veçanta për pranimin dhe përzgjedhjen e kandidatëve në programet e studimit me karakter profesional dhe udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me to.	Institucioni në planin strategjik ka parashikuar vendosjen e lidhjeve të qëndrueshme me tregun e punës dhe rritja e komunikimit me Qendrën e Karrierës dhe Alumni si urë lidhëse mes studentëve dhe kërkesave të këtij të fundit. Marrëveshjet e bashkëpunimi me institucionet e ndryshme mund të shërbejnë si platformë e përshtatshme për punësimin e studentëve pas përfundimit të studimeve (Shtojca 2.10). Sipas stafit të institucionit, para fillimit të studimeve e deri në diplomim, studentët informohen mbi çështje të rëndësishme që lidhen me veprimtarinë e tyre të përditshme akademike, si kriteret e pranimit, procedurat e regjistrimit dhe tarifën, transferimi i studimeve dhe mobilitetet, këshillimin e studentëve, të drejtat e përfaqësimit, veprimtaritë akademike, kulturore, njoftime etj, nëpërmjet “Katalogut të Studimeve” (Shtojca 3.21 dhe Shtojca 3.22).
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, zhvillimin e veprimtarive praktike e profesionale të programit dhe institucionet bashkëpunuese në këto veprimtari, vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve dhe diplomimit.	Studentët mund të gjejnë informacion, gjithashtu edhe në faqen zyrtare të internetit dhe rrjeteve sociale si dhe gjatë vizitës në institucion u vërejt se informacione të ndryshme shpallen, gjithashtu, në stenda dhe
Kriteri 4. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin, kohëzgjatjen e programit të studimeve, mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	
Kriteri 5. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen, veprimtaritë formuese dhe informacion të	

<p>gjerë e të përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>monitorë në mjedise të dukshme në hollet e fakulteteve. Procesi i regjistrimit kryhet sipas procedurave dhe afateve të shpallura nga MASR. Sekretaritetë mësimore lehtësojnë procesin e aplikimit dhe regjistrimit të studentëve (Shtojca 1.10). Çdo procedurë tjetër që lidhet me kuota dhe kriteret transferimi, aplikimi për program të dytë dhe diplomimi miratohen si pjesë e rregullores së programit të studimit (Shtojca 2.5) dhe iu bëhet e ditur studentëve të interesuar.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Në përputhje me përcaktimet e “Rregullores së UK” (Shtojca 1.2) dhe “Rregullores së programit të studimit” (Shtojca 2.5) detajohet struktura akademike e programit në vite/semestra, kreditet dhe format e vlerësimit. Ky informacion publikohet njëkohësisht në sistem dhe u bëhet i ditur studentëve. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen edhe në strukturën e vitit akademik (Shtojca 3.22) dhe si të tilla ruhen në sistem dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik. Në fillim të vitit të parë të studimeve Departamenti i Agrobiznesit organizon takime informuese me studentët e rinj (Shtojca 3.11). Aty prezantohen pedagogët, përshkruhet kurrikula dhe jepet informacion orientues në lidhje me vendndodhjen e auditorëve, zyrave dhe sekretarive, oraret e shfrytëzimit të bibliotekës, leximin e orarit mësimor dhe përdorimin e sistemit informativ ESSE3 (Shtojca 1.6).</p> <p>Në vijim studentëve u bëhen, gjithashtu, të ditura elementë të “Rregullores së organizimit të studimeve”, në lidhje me formën e studimeve, kreditet dhe ngarkesën në auditor, vlerën e lëndëve me zgjidhje, frekuentimin dhe format e vlerësimit, etj. Për komunikimin e brendshëm mes studentëve, pedagogëve dhe sekretarisë mësimore, UNIKO përdor ESSE3 (Shtojca 1.6). Aty studenti mund të aksesojë në çdo kohë informacionin e nevojshëm në lidhje me kurrikulën e programit të studimit, lëndët/modulet dhe ngarkesat përkatëse, syllabuset dhe format e vlerësimit për secilën, informacion në lidhje me frekuentimin, grafikun e provimeve, auditorët, etj. Informacion i detajuar për çdo lëndë/module jepet gjithashtu nga pedagogu përkatës së fillim të semestrit.</p> <ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK - SHTOJCA 1.3 PLANI STRATEGJIK UNIKO 2016-2020 - SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3. -SHTOJCA 1.10 RREGULLORE E SEKRETARISË MËSIMORE - SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.10 MARREVESHJE BASHKEPUNIMI NE MBESHKETJE TE PRAKTIKAVE PROFESIONALE - SHTOJCA 3.11 PRAKTIKA E INFORMIMIT TE STUDENTEVE ME PROGRAMIN E STUDIMIT - SHTOJCA 3.12 STUDIM TREGU PERIODIK NE KUADER HAPJEJE PROGRAMI STUDIMI - SHTOJCA 3.9 PRAKTIKA E MIRATIMIT TE KRITEREVE TE PRANIMIT - SHTOJCA 3.21 KATALOGU I STUDIMEVE - SHTOJCA 3.22 STRUKTURA E VITIT AKADEMIK 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional



Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomimin e daljen në tregun e punës.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL, vërehet se institucioni mbështetet gjerësisht në sistemin digjital ESSE3 për të menaxhuar dhe administruar informacionin që lidhet me aktivitetin mësimor të studentëve (Shtojca 1.6). Në bazë të manualit të këtij programi, institucioni menaxhon sistemin e regjistrimeve, kurrikulën, grafikun e provimeve online, hedhjen dhe ruajtjen e vlerësimit, fazën e paradiplomimit dhe diplomimit. Studentëve u jepen të dhënat e aksesit të llogarive individuale pas regjistrimit përfundimtar në UNIKO dhe ata mund ta aksesojnë atë në çdo kohë, nga çdo pajisje që ka lidhje interneti.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe të partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjithashtu informacioni për studentët në të gjitha etapat e studimit ruhet fizikisht edhe në sekretarinë mësimore, në regjistrat përkatës. Sekretaria mësimore disponon statistika vjetore për numrin e regjistrimeve në çdo vit akademik sipas programeve të studimit dhe cikleve të studimit. Gjithashtu, ajo ruan të dhëna të detajuara në lidhje me numrin e studentëve të secilit viti akademik, transferimet dhe çregjistrimet, ecurinë akademike të studentit, numrin e ECTS të grumbulluara për secilin vit akademik, si dhe të dhënat e studentëve që diplomohen (Shtojca 4).</p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Përveç informacionit të lartpërmendur, sekretaria ruan të dhëna për studentët në formatin e Regjistratit Themeltar të Studentëve, Regjistrin e Diplomimit, etj. Çdo e dhënë koordinohet me sistemin qëndror kombëtar dhe studenti regjistrohet përfundimisht vetëm pasi i njihet numri i matricullimit (Shtojca 1.10).</p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>Informacioni i mësipërm dhe përpunimi i tij statistikor përdoret për analizën periodike mbi cilësinë e studentëve në hyrje dhe në dalje, për shqyrtimin e ecurisë së tyre në kurrikul, për ruajtjen e kontakteve të rregullta me alumni. Ai është pjesë e raporteve të vlerësimit të brendshëm (Shtojca 3.6) dhe i Raportit vjetor të veprimtarisë së Departamenti i Agrobiznesit (Shtojca 3.7).</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ nëpërmjet aksesit që i jep dekanit dhe përgjegjësit të departamentit të kontrollojnë hedhjen në kohë të dokumentacionit të kërkuar, përmbushjen e kriterëve të vlerësimit dhe respektimin e afateve të hedhjes së rezultateve online.</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Për sa i përket faqes zyrtare të institucionit, në momentin e vizitës faqja zyrtare kishte probleme dhe nuk ishte e aksesueshme nga jashtë institucionit.</p> <p>- SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3. - SHTOJCA 1.10 RREGULLORE E SEKRETARISË MËSIMORE. - SHTOJCA 3.6 RAPORTI I PERFITIMEVE NGA MARREVESHJET NE FUNKSION TE PROGRAMIT TE STUDIMIT. - SHTOJCA 3.7 RAPORTET VJETORE TE NJ.S.B.C</p>

- SHTOJCA TABELA PERMBLEDHESE PER PROGRAMIN E STUDIMIT.				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

5 STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
<p>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin, në programin e studimit dhe i vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit</p>	
Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, përparimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, GVJ konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika, procedura dhe kriteret të pranimit, transferimit njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit të studentëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore dhe që aksesohen nga publiku. . Këto informacione gjenden në rregulloren e programit të studimit si dhe në rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore dhe kërkimit shkencor të institucionit (Shtojca 1.2). këto rregullore janë hartuar dhe publikohen bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve të tjera ligjore, sipas propozimeve të bëra nga njësitë bazë dhe të miratura nga Senati Akademik (Shtojca 3.9). Gjithashtu institucioni, bazuar në legjislacionin në fuqi përcakton edhe kuotat për kategori të veçanta si për kandidatët për studentë nga trojet, ose me statusin e jetimit, personat me aftësi të kufizuara, etj. Kriteret e pranimit dhe kuotat për secilin program studimi publikohen nga UNIKO si dhe materiale udhëzuese (Shtojca 3.10 dhe Shtojca 3.11) për kandidatët për student të cilët janë pjesë e kategorive të veçanta të përfshira në kuotat e pranimit. Udhëzime dhe orientime të tjera kandidatët për studentë dhe studentët marrin nga sekretariatë mësimore të UNIKO-së si dhe nga QKA. <i>Për sa i përket publikimit online, siç është konstatuar dhe më lart, faqja zyrtare e institucionit për momentin nuk është funksionale për vizitorët jashtë institucionit. Ky aspekt ka nevojë të përmirësohet.</i> Në rregulloren e organizimit dhe veprimtarisë mësimore, kërkimor shkencor të institucionit e cila mbështetet në legjislacionin në fuqi (Ligji 80/2015) si dhe në Statutin e UK-së (Shtojca 1.1, Neni 2) “Misioni dhe</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje dhe orientimin drejt tregut të punës, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve dhe, përpara fillimit të çdo viti akademik, udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	
<p>Kriteri 4. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm</p>	

<p>në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve, kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Vizioni”, pika 4 thuhet shprehimisht se UNIKO ka për mision “të garantojë shprehjen e lirë të ideve dhe t’i sigurojë personelit dhe studentëve mundësi të barabarta për punë dhe studim.</p> <p>Gjithashtu, siç është vërejtur dhe më sipër, në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Organizimit të Studimeve (Shtojca 1.2) dhe Rregullores së Programit të Studimit (Shtojca 2.5) detajohet struktura akademike e programit në vite/semestra, kreditet frekuentimi, procedurat e kalimit nga njëri vit në tjetrin dhe format e vlerësimit të studentit. Ky informacion publikohet njëkohësisht në sistemin ESSE3 dhe u bëhet i ditur studentëve (Shtojca 1.6). Kreu VI dhe VII i Rregullores së organizimit të studimeve (Shtojca 1.2) përcakton kriteret e shlyerjes të detyrimeve vjetore nga ana e studentëve dhe pragun e kalimit nga njëri vit në tjetrin. Sezonet e provimeve, riprovimeve dhe sezonet e mbartura përcaktohen edhe në strukturën e vitit akademik dhe si të tilla ruhen në sistem dhe u bëhen të ditura studentëve që në fillim të vitit akademik.</p> <p>Studentët informohen në detaje për të gjitha çështjet dhe sidomos për mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive në fillim të cdo moduli mësimor. Këto informacione studentët i gjejnë në Rregulloren e Organizimit dhe Veprimtarisë Mësimore, Kërkimore shkencore e UK, Kreu VII – Procedurat e vlerësimit të studentëve dhe në Rregulloren e programit të studimit ku përcaktohen forma e vlerësimit për çdo modul/lëndë dhe e diplomimit të studentëve.</p> <p>- SHTOJCA 1.1 STATUTI I UK - SHTOJCA 1.2 RREGULLORJA E UK - SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3 - SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 3.10 PRAKTIKA E PROMOVIMIT DHE INFORMIMIT TE MATURANTEVE - SHTOJCA 3.11 PRAKTIKA E INFORMIMIT TE STUDENTEVE ME PROGRAMIN E STUDIMIT - SHTOJCA 3.9 PRAKTIKA E MIRATIMIT TE KRITEREVE TE PRANIMIT</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit dhe diplomimit në programin e studimit.</p>				
<p>Kriteri 6. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>				
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X	

Standardi V.2



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni informon në mënyrë të hollësishme studentët për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, GVJ konstaton se institucioni informon në detaje studentët rreth programit të studimit, në mënyrë të detajuar në lidhje me lëndët dhe modulet që përmban,</p>

<p>dispozicion të tyre, informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit me karakter profesional.</p>	<p>reflektuar në programin mësimor, syllabuset dhe praktikat mësimore (Shtojca 4, Shtojca 2.5, Shtojca 2.7 dhe Shtojca 2.8). Nga vizita në institucion u vërejt se struktura e programit janë të afishuara në këndet përkatëse të fakultetit, pranë departamenteve, në mjedise publike.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Për sa i përket afashimit online, nuk ishte e mundur të konstatohej nëse keto materiale janë edhe ne faqen e universitetit, pasi nuk ishte e aksesueshme. Megjithatë, institucioni ka hartuar një manual për studentët të cilët mund të orientohen dhe të marrin informacion të detajuar rreth strukturës së programit, kohëzgjatjes dhe elementevë të tjerë të rëndësishëm si funksionimi i institucionit, departamentet, sekretariatë mësimore, periudha dhe kohëzgjatja e studimeve, regjistrimet dhe transferimet, pjesëmarrjen në veprimtaritë mësimore, vlerësimin dhe diplomimin. Gjithashtu, në manual studenti gjen informacion edhe për bibliotekat dhe databazat, sigurimin e cilësisë në UNIKO, zyrën e marrëdhënieve me jashtë, koordinatorët Erasmus, Shërbimin e IT, Këshillin Studentor dhe QKA. (Shtojca 3.21).</p>
<p>Kriteri 3. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, studentëve u vihet në dispozicion programi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen, ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar, ngarkesa, temat për çdo javë mësimore, literatura e detyrueshme dhe e rekomanduar për secilën temë, format e kontrollit dhe vlerësimit, niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës dhe literatura bazë dhe ajo e rekomanduar (Shtojca 2.7 dhe Shtojca 2.8). Institucioni ka përgatitur gjithashtu dhe një programi i shkurtuar (Shtojca 3.19), i cili u vihet në dispozicion studentëve të diplomuar në dy gjuhë.</p>
<p>Kriteri 4. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Gjithashtu, siç është vërejtur dhe më sipër, në përputhje me përcaktimet e Rregullores së Organizimit të Studimeve (Shtojca 1.2) dhe Rregullores së Programit të Studimit (Shtojca 2.5) është detajuar struktura akademike e programit në vite/semestra, kreditet frekuentimi, dhe format e vlerësimit të studentit. Ky informacion publikohet njëkohësisht në sistemin ESSE3 dhe u bëhet i ditur studentëve (Shtojca 1.6).</p> <p>Nga biseda me studentët dhe gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua se studentëve i komunikohet koha e kryerjes së praktikës profesionale dhe programin e saj. Praktikrat profesionale zhvillohen në institucione, ndërmarrje publike ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e pedagogut të caktuar nga departamenti përkatës (Shtojca 3.5.). Marrëveshjet ndërinstitucionale të bashkëpunimit nënshkruar midis institucionit dhe njërive bashkëpunuese (Shtojca 2.10) përshkruajnë modalitetet e mënyrës së angazhimit.</p> <p>Kontaktet për punësimin e studentëve rregullohen nëpërmjet QKA, e cila shërben si urë lidhëse midis studentëve dhe tregut të punës dhe krijon kontaktet e duhura me punëdhënësit potencialë (Shtojca 1.5).</p> <ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA) - SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3. - SHTOJCA 2.5 RREGULLORJA E PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.7 PLANI MESIMOR I PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.8 PROGRAMET LENDORE TE PROGRAMIT TE STUDIMIT - SHTOJCA 2.10 MARREVESHJE BASHKEPUNIMI NE MBESHTETJE TE PRAKTIKAVE PROFESIONALE - SHTOJCA 3.5 TABELA E INSTITUCIONEVE BASHKEPUNUESE PER PRAKTIKAT

	- SHTOJCA TABELA PERMBLEDHESE PER PROGRAMIN E STUDIMIT			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit me karakter profesional, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në vitet paraardhëse në programin e studimit.	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, GVJ konstaton se institucioni disponon dhe mban statistika rreth studentëve të diplomuar në vitet paraardhëse (Shtojca 2.20). Mbledhja dhe ruajtja e informacionit kryhet nga sekretaria mësimore, e cila është përgjegjëse për menaxhimin e procesit të regjistrimit të studentëve, për rregullimin, monitorimin dhe arkivimin e çdo regjistrimi, informacioni, dokumenti apo transkripti lidhur me studentët (Shtojca 1.10). Sekretaria Mësimore ka përgjegjësi për hedhjen, administrimin dhe ruajtjen e të dhënave mësimore të studentëve dhe të procesit mësimor dhe në mënyrë të veçantë ka përgjegjësi për plotësimin e regjistrimit bazë të studentëve.</p> <p>Të dhënat për studentët e regjistruar mbahen, përveç se në regjistrin bazë në format të shkruar ashtu edhe në atë elektronik. Regjistrat ruhen në mënyrë të përhershme, në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për Arkivat", dhe janë objekt kontrolli nga organet e ngarkuara për kontroll në bazë të dispozitave ligjore në fuqi. Të dhënat personale të tyre si datëlindja, qyteti i lindjes, adresa kontakti ruhen nga sistemi në mënyrë diskrete dhe janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat IT-it të autorizuar në fakultet dhe rektorat.</p> <p>Sekretaria ruan dokumentacionin e domosdoshëm për çdo student në versionin fizik dhe i hedh këto të dhëna elektronikisht në Programin Digjital të Sistemit Universitar ESSE3 (Shtojca 1.6). Ruajtja e regjistrat elektronik bëhet nëpërmjet sistemit "BACK UP" nga RASH.</p> <p>Ndërkohë, kontaktet me studentët e diplomuar mbahen nga Qendra e Karrierës dhe Alumni, e cila ka një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre, si dhe ofron konsulencë për çështje akademike dhe studentore.</p> <p>Gjithashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar, GVJ vëren se institucioni harton dhe kryen analiza periodike mbi profilit të studentëve që i atashohen UNIKO dhe pas mbarimit të studimeve. Këto raporte analitike janë të paraqitura përgjithësisht në analizën vjetore të Qendrës së Karrierës dhe Alumni (shih Shtojca 3.20).</p> <p style="margin-top: 20px;">- SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3 - SHTOJCA 1.10 RREGULLORE E SEKRETARISË MËSIMORE - SHTOJCA 2.20 ANALIZA E VEPRIMTARISE SE UK. - SHTOJCA 3.20 ANALIZA VJETORE QENDRA E KARRIERES E</p>
Kriteri 2. Institucioni disponon dhe ruan statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	
Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre, përfshirë punësimin eventuale të tyre.	
Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	
Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilit dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe të shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	

	ALUMNIT			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, GVJ konstaton se institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve, reflektuar në rregulloret përkatëse të institucionit. Më specifikisht, studentët kanë të drejtë të përfaqësohen në Senatin Akademik, në komisionet e përheshme dhe të marrin pjesë në zgjedhjet për Rektorin e universitetit dhe Drejtuesit e Njësisë Kryesore (Shtojca 1.19, neni 46, neni 39, neni 42). Gjithashtu, sipas dokumentacionit të dorëzuar vërehet se studentët janë parashikuar të përfshihen edhe në aspektin e sigurimit të cilësisë (Shtojca 3.4). Nga dokumentacioni i dorëzuar konstatohet se studentët përfaqësohen me dy anëtarë në Senatin Akademik (Shtojca 1.11), me një student në Këshillin e Etikës (Shtojca 1.20), me votimin e një anëtari të Bordit të Administrimit, me përfshirjen e tyre në komisionet e NJSBC/GVB (Shtojca 1.5), si dhe në kuadër të sigurimit të cilësisë, akreditimit institucional dhe programeve të studimit (Shtojca 1.16). Një nga strukturë tjetër ku parashikohet përfshirja e studentëve është edhe Këshilli i Studentëve i cili financohet nga universiteti (Shtojca 3.23), dhe promovon pjesëmarrjen e studentëve dhe koordinon përfaqësimin e tyre në organet drejtuese (Shtojca 1.17).
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose e përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	Pjesëmarrja e studentëve në komisionet NJSBC (Shtojca 3.4) GVB (Shtojca 3.3), ka si qëllim të kontribuojë në monitorimin e cilësisë e zbatimit të kurrikulës, nëpërmjet vlerësimeve të stafit (Shtojca 3.14), si dhe nëpërmjet sugjerime në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre. (Shtojca 1.16)
Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	
Kriteri 4. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.	
Kriteri 5. Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<ul style="list-style-type: none"> - SHTOJCA 1.11 RREGULLORE E SENATIT AKADEMIK - SHTOJCA 1.16 MANUALI I CILËSISË UK 2020 - SHTOJCA 1.17 RREGULLORE E KËSHILLIT STUDENTOR -SHTOJCA 1.19 RREGULLORJA PËR ORGANIZIMIN E ZGJEDHJEVE UNIKO - SHTOJCA 1.20 KODI I ETIKËS SË UNIKO. - SHTOJCA 3.3 VENDIMI I NJESISE BAZE PER NGRITJEN E GBV - SHTOJCA 3.4 LISTA E NJ.S.B.C - SHTOJCA 3.14 PYETESORI I STAFIT AKADEMIK - SHTOJCA 3.23 VEPRIMTARI TE KESHILLIT STUDENTOR,

FINANCUAR NGA UNIKO				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht

Standardi V.5

Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët

Kriteret	Vlerësimi
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar pranë ASCAL si dhe nga vizita në Fakultetin e Bujqësisë së Universitetit të Korçës, GVJ konstaton se institucioni ka procedura dhe njësi të posaçme për informimin dhe shërbimin e studentëve, të cilat kryhen nëpërmjet sekretarive mësimore dhe zyrës së informimit të studentëve dhe Qendra e Karrierës dhe Alumni (QKA) (Shtojca 1.5. dhe Shtojca 1.9).</p> <p>Edhe pse strukturat dhe njësitë janë të mirëpërcaktuara në funksionet që ato kanë, cilësia e informacionit që ofrohet ka nevojë të përmirësohet dhe të targetohet më specifikiisht sidomos në aspektin e drejtimit profesional.</p>
<p>Kriteri 2. Në institucion është ngritur dhe funksionon një sistem i posaçëm për mirëpritjen, informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit të dorëzuar, disa nga shërbimet që ofron QKA janë, informim dhe orientim profesional, informacion për bursa, konferenca studimore, praktikë profesionale internship dhe xternship; informacion në lidhje me mobilitetet dhe programet e shkëmbimeve jashtë vendit, si edhe ndihmë përgjatë gjithë procesit të aplikimit etj. Siç shihet, informacioni i ofruar studentëve është i përgjithshëm.</p> <p>Një aspekt tjetër që ka nevojë për përmirësim në lidhje me shërbimin dhe informimin e studentëve është platforma (faqja) online e institucionit e cila duhet të përmirësohet ndjeshëm dhe të bëhet e aksesueshme në çdo kohë.</p>
<p>Kriteri 3. Përmes zyrës/njesisë për këshillimin e karrierës, institucioni mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm lidhur me plotësimin e detyrimeve të procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Informacione më të detajuara për profilin personal të studentit, e gjejnë në faqen e ESSE-3, ku informohen edhe për programet e studimit, provimet, vlerësimet e vazhduara dhe vlerësimet përfundimtare (Shtojca 1.6).</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit, ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse dhe merr masa për përmirësimin e shkallës dhe cilësisë së punësimit të tyre.</p>	<p>Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, GVJ vëren se zyra e karrierës dhe alumni (QKA-ja) bën përpjekje për të gjurmuar dhe mbledhur të dhëna për studentët të cilët përfundojnë studimet në institucion, rreth punësimit të tyre (shih Shtojca 3.20). Sidoqoftë, siç theksohet dhe nga vetë institucioni në raport analizën e QKA për vitin 2019-2020 , cilësia e të dhënave ka nevojë të përmirësohet dhe të rifreskohet në vazhdimësi, në mënyrë që të reflektojë realitetin objektiv por edhe të ndihmojë në përmirësimin e punës për rritjen e cilësisë së punësimit të tyre.</p> <p>- SHTOJCA 1.5 RREGULLORE E DREJTORISË SË KURRIKULAVE (NJSBC, QKA).</p>

	- SHTOJCA 1.6 RREGULLORE E ESSE 3. - SHTOJCA 1.9 RREGULLORE E RRUAJTJES SË TË DHËNAVE. - SHTOJCA 3.20 ANALIZA VJETORE QENDRA E KARRIERES E ALUMNIT.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional “Menaxhim Biznesi Bujqësor” të Institucionit të Arsimit të Lartë Universiteti “Fan S. Noli”, Korçë.

Pikat e forta

1. Karakteristikat tradicionale të zhvillimit të qarkut të Korçës dhe lidhja e programit të studimit me këtë traditë përbëjnë një pikë të fortë që do të sigurojë qëndrueshmërinë e programit të studimit në të ardhmen.
2. Punonjës akademik të motivuar dhe angazhuar për sigurimin e cilësisë së programit të studimit në lidhje me nevojat e qarkut të Korçës.
3. Angazhimi dhe pjesëmarrja e vazhdueshme e stafit akademik në këtë program studimi, në projektet Erasmus Capacity Building, u ofron atyre mundësinë për të përditësuar informacionin në bujqësi, ekonomi dhe mjedis.
4. Analiza e vazhdueshme e programit të studimit është një praktikë e mirë që u komunikon të gjithë palëve të interesuara arritjen e objektivave dhe vlerësimin e tyre.
5. Krijimi i bashkëpunimit me institucionet publike rajonale si bashkitë, qendrat e kërkimit dhe ekstensionit bujqësor si Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore në Korçë dhe Shërbimi i Ekstensionit Bujqësor, ku studentët mund të bëjnë praktikën e tyre profesionale.
6. Interes dhe fokus të fortë nga politikëbërësit për sektorin e bujqësisë, veçanërisht në mbështetjen e të rinjve në bujqësi.
7. Kërkesë e lartë tregu nga sektori i bujqësisë për fuqinë punëtore (të kualifikuar dhe të pakualifikuar).
8. Industria e agropërpunimit është ende e pazhvilluar, por në rritje dhe mund të thithë një fuqi punëtore të kualifikuar.

Pikat e dobëta

1. Mungesa e formalizimit të procedurave për kërkimin e tregut të punës
2. Lidhje e dobët me shkollat e mesme bujqësore në vend.
3. Pjesa praktike e parashikuar në modulet e ndryshme është e kufizuar dhe nuk kryhet sistematikisht duke lidhur proceset e ndryshme bujqësore (prodhimi, mbrojtja e bimëve, ekonomia e fermës, marketingu) nëpërmjet shfrytëzimit më të mirë të fermës didaktike dhe laboratorëve.
4. Literatura dhe materialet mësimore, në disa raste, nuk janë të përshtatura për nevojat dhe nivelin e studentëve (shumë të avancuar, ose të vjetër).
5. Reflektim i dobët në modulet e programit të studimit të sfidave dhe mundësive të së ardhmes për sektorin e bujqësisë në Shqipëri dhe Europë, si ndryshimet klimatike, mbrojtja e biodiversitetit, standardizimi i praktikave bujqësore (certifikimet, G.A.P Global), bujqësia organike etj.
6. Konkurrenca nga IAL- të e tjera që ofrojnë programe të ngjashme studimi.

7. Emigrimi nga zonat rurale i të rinjve që janë studentë potencialë për programin e studimit.
8. Mungesa e interesit për bujqësinë nga të rinjtë.

Rekomandime

1. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon institucionalizimin në nivel fakulteti apo IAL-je të një metodologjie që identifikon nevojat e tregut të punës, ky proces do të rrisë ndjeshëm cilësinë e gjetjeve dhe për rrjedhojë edhe përmbajtjen e programit të studimit.
2. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon që të realizohet dokumentimi i konsultimeve të vazhdueshme me palë të treta në lidhje me përditësimet dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit.
3. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon shtrirjen e bashkëpunimit në një numër më të konsiderueshëm aktorësh rajonalë dhe kombëtarë dhe zyrtarizimin i këtij procesi.
4. Grupi i vlerësimit të jashtëm i rekomandon IAL-së të intensifikojë/përmirësojë shfrytëzimin e platformave online (faqet e internetit, mediat sociale dhe mediumet e tjera) në lidhje me përmbajtjen, ofertën dhe vizionin e programit të studimit për të arritur tek studentët potencialë dhe aktorët publikë dhe privatë që punojnë në bujqësi.
5. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon hartimin e një programi studimi multidisiplinar që merr parasysh sfidat aktuale të bujqësisë dhe mjedisit pasi kjo do t'i mundësojë IAL-së të promovojë dhe rekrutojë profesionistë që punojnë në menaxhimin e biznesit bujqësor dhe studentë të shkollave të mesme.
6. Grupi i vlerësimit të jashtëm rekomandon intensifikimin e bashkëpunimit me shkollat e mesme bujqësore në vend si dhe përditësimin programit të studimit si më poshtë:
 - a) Përfshirja e lëndëve praktike në program lidhur me shkrimin e një projekti dhe parimet e tij.
 - b) Integrimi i aspekteve teknike që lidhen me menaxhimin e mjedisit në programin e studimit duke marrë parasysh tendencat e zhvillimit të bujqësisë dhe zbatimin e parimeve të zhvillimit të qëndrueshëm si dhe inovacioni në bujqësi dhe zhvillim rural.
 - c) Kurse të tilla si Politikat e Menaxhimit të Agrobiznesit mund të shkrihen në një kurs të vetëm për të krijuar mundësinë e përfshirjes së moduleve të tjera që lidhen me praktikën e mira mjedisore në menaxhimin e bizneseve bujqësore.
 - d) Module si Bazat e Marketingut, Çmimet e Produkteve Bujqësore dhe Marketingu Agrar mund të shkrihen në një të vetëm, duke krijuar kështu mundësinë e përfshirjes së moduleve që lidhen me marketingun e territorit dhe integrimin e zhvillimit të agroturizmit.

Conclusions of the Evaluation of the study program with professional character in "Agricultural Business Management" of the Institution of Higher Education University "Fan S. Noli", Korça.

Strengths

1. The traditional characteristics of the development of the Korça region and the connection of the study program with this tradition constitute a strong point that will ensure the sustainability of the study program in the future.
2. Motivated academic employee and committed to ensuring the quality of the study program related to the needs of the Korca region.
3. The continuous engagement and participation of the academic staff in this study program, in Erasmus plus Capacity Building projects, offer them the opportunity to update the information in agriculture, economy, and environment.
4. The continuous analysis of the study program is a good practice that communicates to all the related stakeholders the achievement of the objectives and their evaluation.
5. Established cooperation with regional public institutions such as the Municipalities, agricultural research and extension centres such as Agriculture Technology Transfer Centre in Korca and Agricultural Extension Service, where students can do their professional practice.
6. There is a strong interest and focus by policymakers for the agriculture sector, especially on supporting the youth in agriculture
7. There is a high market demand by the agriculture sector for the labour force (skilled and non-skilled).
8. The agro-processing industry is still underdeveloped but growing and can absorb a skilled labour force.

Weakness

1. Lack of formalisation of procedures regarding job market research
2. Weak connection with agricultural middle schools in the country.
3. The practical part foreseen in the different modules has limited hands-on practical work and is not carried out systematically by connecting the different agricultural processes (production, plant protection, farm economics, marketing) through the better utilisation of the didactic farm and laboratories.
4. Literature and teaching materials are, in some cases, not tailored to the needs and level of students (very advanced, or old).
5. Weak reflection in the modules of the challenges and opportunities of the future for the agriculture sector in Albanian and Europe, such as climate change, biodiversity protection, standardisation of agricultural practices (certifications, Global G.A.P), organic agriculture.
6. Competition from other HEIs that offer similar study programs.
7. - Emigration from rural areas of young people who are potential students for the study program.
8. - Lack of interest in agriculture by young people.

Recommendations

External Evaluation group recommends:

1. Institutionalisation at the faculty or HEI level of a methodology that identifies needs will significantly increase the quality of findings and consequently the study program.
2. Documentation of ongoing consultations with third parties regarding the study program updates and continuous improvement.
3. Extending the cooperation to a more significant number of regional and national actors and formalising this process.
4. An attractive multidisciplinary program design will enable the HEI to promote and recruit professionals working in agricultural business management and high school students.
5. Intensified cooperation with agricultural high schools in the country is recommended.
6. Update the study program as follows:
 - a) Inclusion of practical courses in the program related to writing a project and its principles.
 - b) Integration of technical aspects related to environmental management in the study program taking into account the development trends of agriculture and the application of principles of sustainable development.
 - c) Courses such as Agribusiness Management Policies can be merged in a single course to create the possibility of including other modules related to good environmental practices in the management of agricultural businesses.
 - d) Subjects such as Marketing Basics, Agricultural Product Prices and Agrarian Marketing can be merged into a single one, thus creating the possibility of including modules related to the marketing of the territory and the integration of agro-tourism development.

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përmbushje	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMEVE TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT DHE MBËSHTETJA E STUDENTËVE				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR			X	

